



REPUBLIKA E KOSOVES
MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS
DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTRY OF EDUCATION,
SCIENCE AND TECHNOLOGY
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

UDHËZUES PËR NORMAT DHE STANDARDET E NDËRTESAVE SHKOLLORE

**UDHËZIMET
SPECIFIKE**

VËLLIMI 2







REPUBLIKA E KOSOVES
MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS
DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTRY OF EDUCATION,
SCIENCE AND TECHNOLOGY
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

UDHËZUES PËR NORMAT DHE STANDARDET E NDËRTHESAVE SHKOLLORE

**UDHËZIMET
SPECIFIKE**

VËLLIMI 2



PËRMBAJTJA

PARATHËNIE E VËLLIMIT 2	13
-------------------------	----

1. PARAMETRAT SPECIFIK TË LOKACIONIT	17
--------------------------------------	----

1.1 LOKACIONI I SHKOLLËS	17
1.1.1 PARAMETRAT TOPOGRAFIK	17
1.1.2 KOMPONENTËT DHE KARAKTERISTIKAT E DHEUT	17
1.2 MJEDISI	18
1.2.1 NDIKIMET MJEDISORE	18
1.2.2 MASAT LEHTËSUESE	18
1.3 KLIMA	20
1.3.1 KUSHTET E PËRGJITHSHME KLIMATIKE	20
1.3.2 ZONAT KLIMATIKE	20

2. HAPËSIRAT E BRENDSHME PËR SHKOLLAT FILLORE	25
--	----

2.1 NIVELI PARAFILLOR	25
2.2.1 DHOMA MËSIMORE DHE VERANDA	25
2.2.2 HAPËSIRA PA ZHURMË	28
2.2.3 MJEDISET SANITARE	28
2.2 NIVELI FILLOR	29
2.2.4 DHOMA E MËSIMIT	29
2.2.5 LABORATORI I SHKENCAVE NATYRORE	34
2.2.6 ZYRA E DREJTORIT DHE E SEKRETARIT	38
2.2.7 SALLA E ARSIMTARËVE	38
2.2.8 BIBLIOTEKA	39
2.2.9 HAPËSIRA (SALLA) QË PËRDORET PËR SHUMË QËLLIME	40
2.2.10 MJEDISET SANITARE	43
2.2.11 HAPËSIRAT PËR QARKULLIM	45

3. HAPËSIRAT E BRENDSHME PËR NDËRTHESAT SHKOLLORE TË ARSIMIT BAZIK (THEMELOR)	49
--	----

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	6

4. HAPËSIRAT E BRENDSHME TË SHKOLLAVE TË MESME TË ULËTA DHE TË LARTA 55

4.1 HAPËSIRAT PËR MËSIM	55
4.1.1 DHOMA E MËSIMIT	55
4.1.2 DHOMAT E MËSIMIT - SPECIFIKE	57
4.1.3 LABORATORI I GJUHËS	58
4.1.4 LABORATORËT E SHKENCËS	60
4.1.5 DHOMA E PËRGATITJES DHE E RUAJTJES	64
4.1.6 DHOMA E ARTIT DHE DIZAJNIT	65
4.1.7 DHOMA E MUZIKËS	66
4.1.8 DHOMA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE	68
4.1.9 BIBLIOTEKA DHE QENDRA MEDIALE	71
4.1.10 HAPËSIRA PËR SHUMË QËLLIME	74
4.1.11 HALLA E SPORTEVE	74
4.2 HAPËSIRAT ADMINISTRATIVE	76
4.2.1 PLANI I PËRGJITHSHËM	76
4.2.2 ZYRAT	76
4.2.3 SALLA E ARSIMTARËVE	77
4.2.4 DHOMA E NDIHMËS SË PARË (APO DHOMA E SHËRBIMEVE MJEKËSORE)	77
4.2.5 DEPOJA E MATERIALIT TË ZYRAVE DHE ARKIVA	78
4.3 MJEDISËT PËR SHFRYTËZIM TË PËRBASHKËT DHE ATO PËRCJELLËSE	78
4.2.6 MJEDISËT SANITARE	79
4.2.7 HAPËSIRAT PËR QARKULLIM	79
4.2.8 PUNËTORIA PËR MIRËMBAJTJE	79
4.2.9 KANTINA E SHKOLLËS	79

5. PROJEKTIMI I HAPËSIRAVE TË JASHTME 85

5.1 FUSHAT PËR LOJËRA DHE FUSHAT (HAPËSIRAT) E MBULUARA ME STREHË	86
5.1.1 FUSHAT PËR LOJËRA DHE OBORRET	86
5.1.2 FUSHA E MBULUAR	86
5.2 HAPËSIRAT SPORTIVE	86
5.3 KOPSHTET DHE HAPËSIRAT E MBJELLA	87
5.4 QARKULLIMET E JASHTME DHE ZONAT E PARKIMIT	88
5.4.1 RRUGËT	88
5.4.2 SHTIGJET	88
5.5 RRETHOJA	88
5.5.1 RRETHOJA E KOMPLEKSIT SHKOLLOR	88
5.5.2 PORTAT E KOMPLEKSIT SHKOLLOR	89

6. SHTOJCAT

93

SHTOJCA 1: Dhoma e mësimit / Arsimi Parafillor/ Zona me dendësi të lartë të popullsisë

SHTOJCA 2: Dhoma e mësimit / Arsimi Fillor/ Zona me dendësi të lartë të popullsisë

SHTOJCA 3: Laboratori i shkencave natyrore / Arsimi Fillor/ Zona me dendësi të lartë të popullsisë

SHTOJCA 4: Dhoma përgatitore (laboratori i shkencave) / Arsimi Fillor/ Zona me dendësi të lartë të popullsisë

SHTOJCA 5: Dhoma e mësimit / Arsimi Parafillor/ Zona me dendësi të ulët të popullsisë

SHTOJCA 6: Dhoma e mësimit / Arsimi Fillor/ Zona me dendësi të ulët të popullsisë

SHTOJCA 7: Laboratori i shkencave natyrore / Arsimi Fillor/ Zona me dendësi të ulët të popullsisë

SHTOJCA 8: Dhoma përgatitore (laboratori i shkencave) / Arsimi Fillor/ Zona me dendësi të ulët të popullsisë

SHTOJCA 9: Dhoma e mësimit / Arsimi i Mesëm i Ulët dhe i Lartë/ Zona me dendësi të lartë të popullsisë

SHTOJCA 10: Dhoma e mësimit -specializuar/ Arsimi i Mesëm i Ulët dhe i Lartë / Zona me dendësi të lartë të popullsisë

SHTOJCA 11: Laboratori i gjuhëve / Arsimi i Mesëm i Ulët dhe i Lartë/ Zona me dendësi të lartë të popullsisë

SHTOJCA 12: Laboratori i shkencës / Arsimi i Mesëm i Ulët dhe i Lartë/ Zona me dendësi të lartë të popullsisë

SHTOJCA 13: Dhoma përgatitore (për 2 laboratorë) / Arsimi i Mesëm i Ulët dhe i Lartë/ Zona me dendësi të lartë të popullsisë

SHTOJCA 14: Dhoma përgatitore (për 1 laborator) / Arsimin Arsimi i Mesëm i Ulët dhe i Lartë/ Zona me dendësi të lartë të popullsisë

SHTOJCA 15: Dhoma e artit figurativ / Arsimi i Mesëm i Ulët dhe i Lartë/ Zona me dendësi të lartë të popullsisë

SHTOJCA 16: Dhoma e muzikës / Arsimi i Mesëm i Ulët dhe i Lartë/ Zona me dendësi të lartë të popullsisë

SHTOJCA 17: Dhoma e teknologjisë informative / Arsimi i Mesëm i Ulët dhe i Lartë/ Zona me dendësi të lartë të popullsisë

SHTOJCA 18: Biblioteka dhe qendra mediale / Arsimi i Mesëm i Ulët dhe i Lartë/ Zona me dendësi të lartë të popullsisë

SHTOJCA 19: Salla e sporteve / Arsimi i Mesëm i Ulët dhe i Lartë/ Zona me dendësi të lartë të popullsisë

SHTOJCA 20: Dhoma e mësimit / Arsimi i Mesëm i Ulët / Zona me dendësi të ulët të popullsisë

SHTOJCA 21: Dhoma e mësimit -specializuar/ Arsimi i Mesëm i Ulët / Zona me dendësi të ulët të popullsisë

SHTOJCA 22: Laboratori i gjuhëve / Arsimi i Mesëm i Ulët / Zona me dendësi të ulët të popullsisë

SHTOJCA 23: Laboratori i shkencës / Arsimi i Mesëm i Ulët / Zona me dendësi të ulët të popullsisë

SHTOJCA 24: Dhoma përgatitore (për 2 laboratorë) / Arsimi i Mesëm i Ulët / Zona me dendësi të ulët të popullsisë

SHTOJCA 25: Dhoma përgatitore (për 1 laborator) / Arsimi i Mesëm i Ulët / Zona me dendësi të ulët të popullsisë

SHTOJCA 26: Dhoma e artit figurativ / Arsimi i Mesëm i Ulët / Zona me dendësi të ulët të popullsisë

SHTOJCA 27: Dhoma e muzikës / Arsimi i Mesëm i Ulët / Zona me dendësi të ulët të popullsisë

SHTOJCA 28: Dhoma e teknologjisë informative/ Arsimi i Mesëm i Ulët / Zona me dendësi të ulët të popullsisë

SHTOJCA 29: Biblioteka dhe qendra mediale / Arsimi i Mesëm i Ulët / Zona me dendësi të ulët të popullsisë

SHTOJCA 30: Halla e sporteve / Arsimi i Mesëm i Ulët / Zona me dendësi të ulët të popullsisë

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	8

SHTOJCAT, TABELAT DHE FIGURAT

LISTA E SHTOJCAVE

- V2-01** Përmbledhje teknike – nivel fillor (8 fletë)
- V2-02** Përmbledhje teknike – nivel i mesëm i ulët dhe mesëm i lartë (22 fletë)

LISTA E TABELAVE

- 2.1** Gjerësia minimale për qarkullim
- 3.1** Shkollat standarde për arsimin themelor. Klasat dhe nxënësit
- 6.1** Ndarja e hapësirave të jashtme të shkollës

LISTA E FIGURAVE

- 2-2.1** Dhoma e mësimit për nivelin parafillor
- 2-2.2** Dhomat e mësimit të zakonshme
- 2-2.3** Kabinetet e nivelit fillor
- 2-2.4** Salla përgatitëse për kabinetet e nivelit fillor
- 2.2.5** Diagramet funksional për sallën për përdorim për qëllime të ndryshme
- 2-3.1** Diagrami funksional për shkollat e arsimit bazik(themelor) plani horizontal
- 2-3.2** Diagrami funksional për shkollat e arsimit bazik(themelor) plani vertikal (1)
- 2-3.3** Diagrami funksional për shkollat e arsimit bazik(themelor) plani vertikal (2)
- 2-4.1** Planet (organizimi) për dhomat e mësimit të specializuara
- 2-4.2** Laboratori i gjuhëve
- 2-4.3** Planet (organizimi) për laboratorin e shkencës
- 2-4.4** Dhoma përgatitëse për laboratorët e shkencës
- 2-4.5** Dhoma e muzikës
- 2-4.6** Plan për dhomën e teknologjisë informative
- 2-4.7** Diagrami funksional i bibliotekës dhe qendrës mediale
- 2-4.8** Diagrami funksional i sallës së sporteve
- 2-4.9** Diagrami funksional i administratës
- 2-4.10** Diagrami funksional i kantinës

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

MMK	Madhësia mesatare e klasës
KKTV	Këshilli për kurrikulum, tekste shkollore dhe vlerësim
EMIS	Sistemi informativ për menaxhimin e arsimit
PMM	Plani për menaxhimin mjedisor
BE	Bashkimi Evropian
NPD	Niveli i përfunduar i dyshemesë
SIGj	Sistemi informativ gjeografik
SPG /GPS/	Sistemi i pozicionimit global
DI	Departament i Infrastrukturës
IDEP	Projekti për Zhvillimin Institucional të Arsimit
IDA	Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar
GKA	Granti komunal për zhvillimin e arsimit
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
OJQ	Organizatë joqeveritare
OZhEB	Organizata për Zhvillim Ekonomik dhe Bashkëpunim
PNM	Proporcioni nxënës – mësimdhënës
DSO	Dokumentet standarde për ofertim
GZhSh	Granti për zhvillimin e shkollës
PDP	Përshkrimi i detyrave të punës
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
AAP	Arsim dhe aftësim profesional
GZhSh	Grant për Zhvillim të Shkollës
TeR	Termet e Referencës
UNMIK	Mision i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
AAP	Arsim dhe Aftësim Profesional

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	10

KODET TREGUESE

NIVELET E ARSIMIT:

AP	Arsimi parafillor (Niveli - 0)
AF	Arsimi fillor (Niveli – 1-5)
APF	Arsimi parafillor dhe fillor (Niveli – 0/1-5)
AB	Arsimi Bazik (themelor) (Niveli – 0-9)
AMU	Arsimi i mesëm i ulët (Niveli – 6-9)
AML	Arsimi i mesëm i lartë (Niveli – 10-12)
AMU/L	Arsimi i mesëm i ulët dhe i lartë (Niveli – 6-12)
GJN	Të gjitha nivelet (Niveli – 0-12)

LLOJI I SPECIFIKIMIT		KODI	NORMA APO SPECIFIKIMI
0	Referencat	REF	Listat e shtojcave, tabelave, figurave, shkurtesave
1	Hyrja	HYR	
2	Konceptet e projektimit	KP	Planifikimi (Programimi) i hapësirave Projektimi i hapësirave Mundësia për qasje
3	Parimet e përgjithshme	PP	Normat teknike Siguria dhe mbrojtja Parametrat e komoditetit Inventari dhe pajisjet
4	Parametrat specifikë	PS	Lidhur me tiparet dhe kufizimet e lokacionit Lidhur me mjedisin Lidhur me klimën
5	Udhëzimet për hapësirat e brendshme	HB	Hapësirat për mësim Hapësirat e administratës Hapësirat përcjellëse
6	Udhëzimet për hapësirat e jashtme	HJ	Fushat e lojës dhe strehët e hapura Fushat sportive Shtigjet, rrugët, parkingu, hapësirat e gjelbëruara, rrethoja



PARATHËNIE E VËLLIMIT 2

Sikurse është përmendur më parë në Hyrjen e Vëllimit të parë (Kapitulli 1, paragrafi 1.3.2), këto udhëzime janë përgatitur në dy vëllime, secili për nivelin përkatës të arsimit:


- (i) **Të dhënat dhe udhëzimet e përgjithshme** në kapitujt 2 dhe 3 të vëllimit të parë:
 - Konceptet e projektimit; dhe
 - Normat e përgjithshme.
- (ii) **Karakteristikat specifike të lokacionit, të dhënat dhe udhëzimet e detajuara** në kapitujt 1 dhe 5 të vëllimit të dytë:
 - Parametrat specifik të lokacionit;
 - Udhëzimet për hapësirat e brendshme; dhe

- Udhëzimet për hapësirat e jashtme.

Në këtë vëllim, projektuesit (dizajguesit) në vijim mund të gjejnë:

- (i) Tekstin kryesor me specifikacione, kërkesa, diagrame dhe skema funksionale të hapësirave;
- (ii) Programet korresponduese të akomodimit me sasi dhe sipërfaqe që korrespondon për çdo shkollë standarde që janë në shtojca të vëllimit të parë, dhe
- (iii) Tabelat përkatëse me përmbledhje teknike të dhëna në shtojcat e këtij vëllimi. Referencat për këto shtojca janë dhënë në tekstin në fund të çdo paragrafi.







1. PARAMETRAT SPECIFIK TË LOKACIONIT

Gjersa udhëzimet e përgjithshme të shtruara në vëlimin e parë në përgjithësi zbatohen për të gjitha shkollat, duhet t'ju përkujtojmë se nuk ekziston vetëm një zgjidhje e vetme projektuese. Në të vërtetë, secili projektim varet nga kushtet specifike lokale përfshirë, ato që kanë të bëjnë me (i) **lokacionin e shkollës** siç janë: karakteristikat gjeografike, lokacionin dhe qasjen në vendndodhjen e shkollës, madhësinë dhe formën e lokacionit; (ii) **kushtet klimatike** siç janë: temperatura, lagështia relative, reshjet dhe drejtimi mbizotërues i erërave, dhe (iii) **kushtet mjedisore** siç janë: aktivitetet rrethuese, afërsia me ndërtesat fqinje, rrjetet ekzistuese të shërbimeve komunale, rrethojat dhe një numër faktorësh të tjerë specifik.

1.1 LOKACIONI I SHKOLLËS

Përzgjedhja e lokacionit për shkollat e reja duhet të bazohet në disa kritere të ndryshme, në varësi të zonës gjeografike (urbane ose rurale), nivelin e arsimit, kapaciteti fillestar i vlerësuar i nxënësve dhe zgjerimet e mëtejme.

Ndër të tjera, cilësitë e brendshme të lokacionit dhe të mjedisit të tij rrethues duhet të vihen në dukje, të shënohen dhe të vlerësohen, siç janë pamja e jashtme, afërsia me zhvillimet ekzistuese në fqinjësi ose të atyre potenciale, cilësia e shtresës së sipërme të dheut, vegjetacionit ekzistues që mund të ruhet në mënyrë të dobishme dhe dëshmia e rrugëve të kullimit të ujit sipërfaqësor përveç topografisë, e cila do të përcakto-

het nga matjet gjeodezike. Lokacioni dhe rrethinat e tij duhet të jenë gjithsesi të regjistruara edhe me fotografi.

1.1.1 PARAMETRAT TOPOGRAFIK

Ekipi i projektuesve duhet të bëjë një anketë të balancuar të lokacionit dhe madje edhe nëse informatat e anketës tashmë ekzistojnë, kjo gjë duhet të verifikohet. Parametrat dhe kriteret kryesore topografike që duhet të vlerësohen janë: (i) kufijtë duhet të shënohen qartë;; (ii) pikat më të larta dhe konturat e lokacionit me të gjitha veçoritë natyrore që duhet të jenë kompatible me aktivitetet shkollore; (iii) hapësira e gjithëmbarshme e lokacionit duke pasur parasysh edhe hapësirat e papërshtatshme për ndërtim ose për t'u përdorur për lojëra në ambient të hapur për shkak të pjerhtësisë ose arsyeve të tjera të ndryshme; dhe (iv) ndërtesat ekzistuese në atë lokacion që duhet të parcelizohen në planin e lokacionit.

1.1.2 KOMPONENTËT DHE KARAKTERISTIKAT E DHEUT

Kriteret kryesore të përzgjedhjes sa u përket komponentëve të dheut kanë të bëjnë me rezistencën dhe llojin e dheut. Këto elemente mund të përfitohen me anë të hartave gjeologjike të rajonit në fjalë, por karakteristikat e detajuara të lokacionit mund të përfitohen vetëm përmes testeve dhe analizave të dheut. Në çdo rast,

Niveli	Tema	Faqe
GJN	PS	18

gjatë përzgjedhjes së lokacionit duhet të shmangen të gjitha lokacionet me hapësira të mëdha të mbushura sërish me dhe, vende ku ka rrëshqitur dheu më parë, zonat moçalore, zonat sizmike, erozionin dhe rrëshqitjet serioze të dheut.

Inxhinieri përkatës do të kërkojë vrima provuese ose shpime për të përcaktuar kapacitetin mbajtës të ngarkesës dhe kushteve të nëndheshme nëpër lokacion dhe posaçërisht në zonat ku do të vendosen ndërtesat. Ai do të sigurohet se stabiliteti struktural dhe kapaciteti për mbajtjen e ngarkesës së themeleve mund të përfitohet pa shumë shpenzime të mëdha. Për ndërtesat ekzistuese, inxhinieri ekzistues duhet të kryejë analiza për të përcaktuar qëndrueshmërinë strukturale dhe të vendosë se çfarë ngarkesa të tjera mund të barten për një zgjerim vertikal.

1.2 MJEDISI

1.2.1 NDIKIMET MJEDISORE

Kriteret për përzgjedhjen e lokacionit të shkollës zakonisht udhëhiqen nga disponueshmeria me tokën dhe rregulloret e planifikimit të qytetit. Megjithatë, kriteret që kanë të bëjnë me çështjet mjedisore dhe lokacionin fqinj, janë si vijon:

(a) Zonat urbane

Në zonat urbane dhe periferike, përzgjedhja e lokacionit duhet të merr parasysh këto kriterë: (i) aktivitetet në fqinjësi nuk duhet të prodhojnë zhurmë, tym ose kutërbim që do të mund të rrezikonte shëndetin e banorëve; (ii) akset kryesore të trafikut (rrugor, hekurudhor, aeroporti...) duhet të jenë mjaft larg nga lokacioni i shkollës; dhe (iii) sa më shumë që është e mundur duhet të ketë rrjete ekzistuese të infrastrukturës publike në afërsi.

(b) Zonat rurale

Lokacionet e shkollave do të përzgjidhen në bazë

të këtyre kriterëve mjedisore: (i) topografia lokale të mundësojë qasje të lehtë dhe të pranueshme në lokacion; (ii) të ketë rrugë në atë zonë që mundëson qasje për veturat; (iii) të ketë mundësi për furnizim me ujë në afërsi (rrjeti, pusi, puse me shpim, burim i ujit); dhe (iv) të ketë pajisje të tjera publike dhe/ose zona të banuara në fqinjësi.

1.2.2 MASAT LEHTËSUESE

(a) Para ndërtimit

Gjatë hartimit të projektit projektuesi dhe përfituesi duhet:

- Të sigurojnë vendosjen e një tabele njoftuese në mënyrë që qytetarët dhe pronarët e tokave në afërsi të mund të shohin qartazi qëllimin e komunës dhe të MASHT-it për ndërtim, dhe nëse ka ndonjë kontest, atëherë i njëjti duhet që të ngritët dhe të trajtohen sa më shpejt që të jetë e mundur;
- Të bëjnë një vlerësim të shpejtë paraprak lidhur me përshtatshmërinë e lokacionit për ndërtimin e planifikuar, duke pasur parasysh kriteret për përshtatshmërinë e lokacionit të dakorduara me Departamentin përkatës në MASHT. Këto kriterë janë e vetmja bazë sipas së cilës ekipi i planifikuesve mund të pranojë lokacionin apo ta refuzojë atë si të papërshtatshëm;
- Të verifikojnë disponueshmërinë, pozitën dhe besueshmërinë e shërbimeve komunale, duke përfshirë energjinë elektrike, furnizimin me ujë dhe pozitën e rrjetit kryesor të kanalizimit për një lidhje të mundshme në to. Duhet të theksohet se duhet të ekzistojë një largësi minimale horizontale prej 50 metra mes përçuesve të rrymës dhe ndërtesave shkollë, si dhe largësi minimale horizontale prej 100 metra në mes objekteve

rrezatuese dhe ndërtesave shkollore

(b) **Gjatë ndërtimit të shkollës**

Përfshirja e masave lehtësuese në kuadër të obligimeve të kontraktuesit dhe plani i saktë lehtësues do të ndihmojë në minimizimin e shumicës së problemeve mjedisore që mund të dalin gjatë ndërtimit (pluhuri, mbeturinat, kemikaljet, zhurma, etj.). Megjithatë pasi që këto ndikime dhe masa nuk janë drejtpërsëdrejti të lidhura me planin e ndërtimit, kjo fazë nuk trajtohet në këtë udhëzues.

(c) **Gjatë punës së shkollës**

Gjatë fazës së punës së shkollës, duhet të ndërmerren masa për ruajtjen e mjedisit natyror të shkollës të cilat kryesisht janë të ndërlidhura me ruajtjen e resurseve dhe me menaxhimin e mbeturinave.

Ky udhëzues trajton vetëm çështjet që kanë të bëjnë me programimin dhe projektimin e ndërtesave shkollore. Çështjet e tjera mjedisore përmenden vetëm si referenca.

(i) **Kursimi i energjisë**

Projektuesit dhe menaxherët e shkollave duhet të marrin parasysh disa masa për kursimin e energjisë elektrike. Ndër këto masa mund të përmendim:

- Përdorimin maksimal të dritës nga dielli në dhomat e mësimi përmes projektimit të tavaneve dhe dritareve të larta;
- Pajisjet e zyrës të jenë sa më ekonomizuese në aspektin e kursimit të energjisë dhe që mundësitë për kursim të energjisë të jenë në dispozicion me rastin e blerjes së makinave të fotokopjimit, kaldajave, dritave të sigurisë dhe pajisjeve ngrohëse e atyre ftohëse;
- Kursimi i energjisë, përqendrimi në energjinë e ripërtëritshme dhe zvogëlimi i emetimit të ga-

zrave me efekt të serrës;

- Nivelet e ndriçimit duhet të jenë të duhura për detyrat që zbatohen. Shkollat duhet të maksimizojnë ndriçimin diellor, të instalojnë sensorët e dritës diellore apo të lëvizjes, përdorimi i poqave ekonomik dhe të shkyçen dritat që nuk përdoren.

(ii) **Kursimi i ujit:**

Burimet ujore janë të pakta dhe të shtrenjta. Rrjedhimisht projektuesit duhet:

- Të hulumtojnë dhe t'i parashohin mundësitë për kursimin e ujit;
- Të propozojnë shfrytëzimin e ujërave atmosferikë për fontanat e tualeteve, ujitjen e kopshteve dhe për larjen e ndërtesave. Ky sistem nënkupton një rrjet të dyfishtë të furnizimit dhe deponim të mjaftueshëm në rezervarët nëntokësorë të ujit dhe/apo në rezervarët me pompa.;
- Të insistojnë në krijimin e një sistemi të mirëmbajtjes (duke përfshirë fushatat e ndërgjegjësimit të nxënësve dhe mësimitdhënësve) të cilat dukshëm do të zvogëlojnë humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve, posaçërisht të atyre humbjeve nga fontanat e tualeteve.

(iii) **Menaxhimi dhe riciklimi i mbetjeve të ngurta**

Mbetjet e ngurta të shkollave duhet të menaxhohen, të trajtohen dhe mundësisht të riciklohen duke pasur kujdes për mjedisin. Riciklimi i letrës dhe kartonit, që janë mbetjet më të shumta nga mbetjet e ngurta të shkollave, duhet të cilësohet si prioritet. Projektuesi duhet:

- Të organizojë dhe të ofrojë mjedise për grumbullim, ruajtje, largim dhe riciklim me qëllim të minimizimit të mbeturinave në kompleksin shkollor;
- Të ofrojë vende të mjaftueshme për deponimin e mbeturinave të ngurta (mundësisht një pllakë betoni të rrethuar me mure mbrojtëse dhe tel gjembor), me kontejnerë të mbyllura për të shmangur kundërmimet dhe shpërndarjen e mbeturinave

Niveli	Tema	Faqe
GJN	PS	20

nga era apo kafshët;

- Të parashohin ndërtimin/instalimin e një furre për djegien e mbeturinave në ato lokacione ku shërbimet publike për grumbullimin e mbeturinave nuk funksionojnë;

Pasi që të grumbullohen dhe deponohen, këto mbeturina mund të trajtohen sipas këtyre tri opsioneve: Të riciklohen (të sortohen), të digjen apo të transportohen te ndonjë deponi e autorizuar.

(iv) **Menaxhimi i mbeturinave të veçanta**

Mësimi nga lënda e kimsë dhe ajo e biologjisë rezulton në prodhimin e mbeturinave të veçanta me rreze të aksidenteve (shih vëllimin 1, paragrafin 3.3.2 më lartë), të cilat duhet të vlerësohen dhe të trajtohen për të ofruar masa lehtësuese për sigurinë e nxënësve dhe për mbrojtjen e mjedisit të shkollës. Në laboratorë të shkollave shumica e mbetjeve kimike me një trajtim të duhur mund të largohen përmes lavamanëve nëse ato produkte nuk janë helmuese:

- Acidet e holluara apo solucionet themelore mund të largohen përmes lavamanëve pas një hollimi shtesë;
- Acidi i koncentruar apo solucionet themelore duhet të ruhen me kujdes, të trajtohen dhe të neutralizohen para hedhjes në lavaman.

(v) **Menaxhimi i mbetjeve të lëngshme**

(SHIH VËLLIMIN 1, PARAGRAFIN 3.3.3. LIDHUR ME RRJETET E KANALIZIMIT, REZERVARËT DHE GROPAT SEPTIKE)

1.3 KLIMA

1.3.1 KUSHTET E PËRGJITHSHME KLIMATIKE

(SHIH VËLLIMIN 1 PARAGRAFIN 3.2.1)

Nocioni i komoditetit klimatik është shumë subjektiv dhe dallon shumë prej individit në individ dhe madje edhe prej një vendi në tjetrin. Rrjedhimisht, projektuesit dhe hulumtuesit e kanë vështirë ta kuantifikojnë këtë nocion në funksion të kriterëve të komoditetit. Megjithatë, hulumtimet e ndryshme për gjetjen e zgjidhjes për kuantifikimin e këtyre kriterëve të komoditetit bazohen në ndjenjën e komoditetit, e cila ekziston me rastin e ekuilibrit të nxehtësisë së krijuar trupore dhe asaj të liruar nga trupi.

Testet dhe studimet hulumtuese të cekura më lartë kanë treguar se fitimi apo humbja e nxehtësisë është rezultat i ndryshimeve të karakteristikave të ajrit, duke përfshirë avullimin, rrymimin, përçimin dhe sasinë e rrezeve. Për më tepër, ato tregojnë se avullimi dhe rrymimi modifikohen nga lagështia dhe nga lëvizjet e ajrit në ndërtesë, të cilat është vështirë të kontrollohen pa ajrosje mekanike apo klimatizim të ajrit.

Përmirësimi i komoditetit termik në ndërtesat shkollare mund të bëhet me (i) rritjen ose zvogëlimin e lëvizjes së ajrit, gjë e cila është mjaft vështirë të arrihet (përveç me flutura të ajrit) dhe (ii) kontrollin e rrezatimit diellor, që është më lehtë të arrihet përmes orientimit të duhur të objektit dhe (apo) shtimit të tendave, strehëve dhe mburojave nga dielli.

1.3.2 ZONAT KLIMATIKE

Siç është cekur më herët në Vëllimin 1 në paragrafin 3.2.1 (b), Kosova është e ndarë në tri zona klimatike të ndryshme, dhe atë në:

- Klimën e Rrafshit të Kosovës, e cila ndikohet nga

- masat kontinentale të ajrit dhe ka dimra të ftohtë;
- (ii) Klimën e Rrafshit të Dukagjinit, e cila ndikohet kryesisht nga masat e ajrit të nxehtë dhe ka temperatura mesatare të ajrit, me të reshura të mëdha të borës gjatë dimrit.
 - (iii) Klimën e bjeshkëve dhe maleve, e cila karakterizohet me klimën tipike malore, e cila ndërlidhet me të reshura të mëdha atmosferike, me vera shumë të shkurtra dhe të ftohta dhe me dimra shumë të ftohët e me shumë borë.

Për shkak të shirave dhe borës së madhe gjatë dimrit, kulmet e zakonshme në Kosovë ndërtohen me dy apo katër pjerrtësi. Megjithatë ndërtesat e larta në qytete dhe në periferi mund të shihen edhe me kulme të rrafshëta apo me një pjerrtësi.



2



2. HAPËSIRAT E BRENDSHME PËR SHKOLLAT FILLORE

2.1 NIVELI PARAFILLOR

Fëmijët e nivelit parafillor mësohen për të zhvilluar aftësitë dhe njohuritë themelore përmes lojës kreative dhe bashkëveprimit shoqëror, si dhe ndonjëherë përmes mësimave formale. Ata vijnë në këtë nivel për të mësuar komunikimin, lojën dhe të bashkëveprojnë me të tjerët. Për fëmijët që paraprakisht kanë kaluar pjesën më të madhe të kohës në shtëpi, klasa parafillore mund të shërbejë për të përshtatur jetesën larg prindërve pa u shqetësuar. Kjo mund të jetë mundësia e parë për të lozur dhe bashkëpunuar me grupin e njëjtë të fëmijëve në bazë të rregullt.

2.1.1 DHOMA MËSIMORE DHE VERANDA

(SHIH V2 SHTOJCËN 01 TABELËN U01 DHE R01)

(a) Aktivitetet

Në fushëlojë, mësimdhënësit japin materiale dhe aktivitete të ndryshme për të motivuar fëmijët që të mësojnë gjuhën dhe fjalorin, matematikën dhe shkencën si dhe muzikën, artin dhe sjelljen sociale.

Puna dhe loja e fëmijëve ka diapazon të gjerë të aktiviteteve stimuluese të njohjes që çon në përgatitje për shkollimin fillor. Këto aktivitete mund të jenë spontane, shpjeguese, të trilluara apo të strukturuar. Ato mund të përfshijnë zhvillimin fizik të fëmijës përmes manipulimit të objekteve,

materialeve dhe pajisjeve, vallëzimit, muzikës, vizatimit dhe stimulimeve tjera intelektuale dhe sociale siç janë lojërat kolektive apo individuale dhe përmes mësimit të leximit dhe kalkulimit.

(b) Plani dhe kapacitetet

Kapaciteti i hapësirës së brendshme është 24 fëmijë për densitet të ulët apo vise rurale dhe 30 deri 36 fëmijë për densitet të lartë apo vise urbane, dhe hapësirat e sugjeruara për ato hapësira janë 2.5 m² dhe 2.3 m² për nxënës. Pjesa e hapësirës për lojë mund të jetë 3 apo 4 metra gjerësi me pjesën e verandës së mbyllur që lidhet drejtpërdrejtë me hapësirat e brendshme dhe të jashtme të lojës.

Të dyja hapësirat, e brendshme dhe e jashtme, duhet të përbëjnë një hapësirë të madhe me një apo disa hapësira më të vogla ku fëmijët zgjedhin aktivitetet e tyre. Megjithatë, këto hapësira duhet të dizajnohen në aso mënyre që mundësojnë mbikëqyrjen e lehtë të klasës dhe të fushëlojës. Këto objekte janë karakteristike dhe duhet të përfshijnë hapësirat për ekspozitë, përfshirë: (i) hapësirat për art dhe grafikë të fëmijëve, që gjenden në pah të fëmijëve së bashku me pjesën e sigurt për të ekspozuar artin dhe projektet tredimensionale të fëmijëve; (ii) hapësirat për objektet që fëmijët i sjellin për t'i ekspozuar para të tjerëve apo që kanë kuptim të rëndësishëm për ta

Niveli	Tema	Faqe
AB	HB	26

DHOMË MËSIMI

Niveli parafillor 24 nxënës




FIG. 2-2.1 SHEMBULLI (I) I ORGANIZIMIT TË HAPËSIRËS PËR DHOMA MËSIMI PËR NIVELIN PARAFILLOR




FIG. 2-2.1 SHEMBULLI (II) I ORGANIZIMIT TË HAPËSIRËS PËR DHOMA MËSIMI PËR NIVELIN PARAFILLOR

Niveli	Tema	Faqe
AB	HB	28

(c) Punët përfundimtare

- Dyshemetë të lëmueshme, që pastrohen lehtë;
- Mure të ngjyrosura, me tabela të shpalljeve;
- Tavane nga pllakat akustike me kohë të shkurtër të jehonës;
- Ngjyra dhe orendi me tone neutrale apo ngjyra të tonit të mesëm për sfonde dhe tavane për të reduktuar kontrastin dhe shkëlqimin me faktor të mjaftueshëm të reflektimit, me ngjyra të ngrohta.

(d) Kushtet e sigurisë

Mbrojtja e jashtme e fëmijëve parafillor përbëhet kryesisht nga rrethoja (së paku 1,5 metra e lartë) për të penguar nxënësit e shkollës fillore që mos të futen në hapësirat e lojës së fëmijëve parafillor. Mbrojtja kundër rreziqeve të brendshme do të përfshijë:

- Orenditë që kanë qoshe gjysmërrethore e jo këndore, në veçanti ato që janë në lartësi të kokës së fëmijës, dhe
- Shkallët që duhet të përputhen me madhësinë e fëmijëve
- Instalimet elektrike duhet të vendosen në vende ku fëmijët nuk mund t'ia arrijnë,

(e) Pajisjet dhe orenditë

Orenditë dhe pajisjet e parafillorit duhet të adaptohen madhësisë së trupit të fëmijëve. Ato gjithashtu duhet të jenë të lehta për transport nga fëmijët ashtu që ata të mund t'i lëvizin rreth e përqark nëpër hapësirat e brendshme dhe të jashtme. Orenditë dhe pajisjet e brendshme duhet të përfshijnë: Karriget dhe tavolinat palosëse, tabelat e madhësive të ndryshme, karro lëvizëse, rafte, tabelë shkrimi e fiksuar dhe e lëvizshme, dollapë dhe ulëse.

Pajisjet e jashtme mund të përfshijnë: Gropë me rërë, kornizë për ngjitje, rrëshqitëse, struktura të ndryshme për lojë dhe luhaja.

2.1.2 HAPËSIRA PA ZHURMË**(a) Aktivitetet**

Dhoma e qetë dizajnohet që fëmijëve t'u jepet mundësia që të kalojnë kohë në qetësi, larg "turmes" në fushëlojë ku edhe mund të mbikëqyren. Aktivitetet e fëmijëve në këtë hapësirë kryesisht përfshijnë lojëra të qeta, lexim dhe pushim.

(b) Plani dhe kapacitetet

Hapësira e qetë mund të jetë dhomë apo hapësirë e ndarë e dhomës kryesore me ndarje të përkohshme nga fushëloja kryesore përmes ndarjeve të lëvizshme. Kjo hapësirë duhet të ketë kapacitet prej së paku dhjetë fëmijëve.

(c) Pajisjet dhe orenditë

[ORENDITË E NJËJTA SIKURSE PËR KLASAT PARAFILLORE (SHIH PARAGRAFIN 2.1.1 MË LARTË)].

2.1.3 MJEDISËT SANITARE

Tualetet për fëmijë vendosen në afërsi dhe duhet të kenë qasje të lehtë. Madhësia e të gjitha instalimeve sanitare i adaptohet madhësisë së fëmijëve.

(i) WC:

- Hapësirat minimale për WC janë 1.20 m x 0.90 m, nëse dera hapet jashtë, dhe 1.40 m x 0.90 m, nëse dera hapet brenda;
- Numri minimal i kabinave për WC është një kabinë për 15 fëmijë (mundësisht një bllok me 3 kabina që gjenden afër dy klasave);

- WC-të duhet të jenë të pajisura me tualete, të përshtatura me madhësinë e fëmijëve.
- Në raste ku është e mundur preferohet shfrytëzimi i ujërave atmosferik për shpëlarje.

(ii) **Lavamanët:**

- Vendosen afër kabinave WC dhe në afërsi të fushëlojave kryesore;
- Numri minimal i lavamanëve është një lavaman për 15 fëmijë;
- Të instaluar në lartësinë e duhur me atë të fëmijëve;
- Instalimet dhe krojet të jenë të fiksuara fort.
- Në raste ku është e mundur preferohet furnizimi me ujë të ngrohtë në lavamane.

(iii) **Kushtet për komoditet:**

- Kërkohet ajrosja natyrale, rekomandohet edhe ajrosja mekanike;
- Kërkohet mbrojtja kundër rrezeve të tepërta të diellit për t'iu shmangur nxehtësisë dhe lagështisë.
- Kërkohet lartësia minimale e kthinës minimum 3m (dyscheme-plafon)

(iv) **Kushtet teknike:**

- Kontrolli i ujit: rekomandohen sisteme të krojeve dhe të shpëlarjes me kontroll automatik të vaskave me qëllim të zvogëlimit të humbjes së ujit;
- Duhet të instalohen sistemet e duhura të kullimit të ujit, të sifoneve dhe të pastrimit;
- Instalimet e sanitarisë duhet të përzgjidhen në bazë të cilësisë së mirë dhe qëndrueshmërisë afatgjatë;
- Muri dhe shtresa e sipërme e dyshemesë duhet të jetë e lehtë për pastrim (muri gjer në 1.80 m);
- Hapësirat duhet të jenë të projektuara në

atë mënyrë që të mundësojnë pastrim dhe mirëmbajtje të lehtë.

2.2 NIVELI FILLOR

2.2.1 DHOMA E MËSIMIT

(SHIH V2 SHTOJCËN 01 TABELËN U02 DHE R02)

(a) **Aktivitetet**

- Mësimdhënia e lëndëve të përgjithshme, ashtu siç është përcaktuar në kurrikulumin zyrtar, siç janë matematika, gjuha amtare dhe angleze, shkencat natyrore, edukata qytetare dhe lëndët e tjera.
- Ligjëratat; demonstrimet, duke përdorur nganjëherë pajisjet audiovizuale; ushtrimet me gojë dhe me shkrim, korrigjimet në dërrasën e zezë, etj;
- Puna në grupe, kurset interaktive...
- Mësimi plotësues, dhoma e mësimit mund të shfrytëzohet për aktivitete jashtëkurrikulare, siç mbledhjet, shkolla të natës, aktivitetet socio-kulturore, etj...

(b) **Plani dhe kapaciteti (SHIH ILUSTRIMIN 2-2.2 19)**

Kapaciteti i klasave është 24 fëmijë për densitet të ulët apo vise rurale dhe 30 deri 36 fëmijë për densitet të lartë apo vise urbane, dhe hapësirat e sugjeruara për nxënës janë 1.6 m² dhe 1.9 m² me hapësirë të njëjtë për çdo nxënës në të tri rastet. Madhësia, forma dhe fleksibiliteti i hapësirave të mësimit janë faktorë kyçë në krijimin e hapësirës pozitive të mësimit. Kushtet ku mësimi zhvillohet me hapësira të tejmbushura, me hapësira tepër të vogla për nxënës, ku rrjedhimisht ata nuk do të jenë në gjendje të ballafaqohen me stile të ndryshme të mësimdhënies, janë një nga shkaqet

Niveli	Tema	Faqe
AB	HB	30

kryesore të shqetësimit përkitazi me projektimin e dhomave të mësimi.

- Bankat nuk duhet të jenë shumë afër njëra-tjetrës, dhe duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme që nxënësit të lëvizin lirshëm;
- Hapësira për lëvizje përfshinë: (i) qarkullimin që ia mundëson mësimdhënësit qasjen e shpejtë tek nxënësi pavarësisht planit të dhomës së mësimi; (ii) hapësirë për qëndrim prapa secilit nxënës me qëllim të diskutimit të punës së tyre; dhe (iii) hapësirë personale.

(c) Punët përfundimtare

- Dysheme të lëmueshme;
- Mure të ngjyrosura ose të veshura me pllaka gipsi të qëndrueshme në goditje;
- Tavane të veshura nga pllakat akustike me kohë të shkurtër të jehonës;
- Ngjyra me tonalitete mesatar me qëllim të zvogëlimit të kontrastit dhe shkëlqimit, me faktor të mjaftueshëm të reflektimit.

(d) Pajisjet dhe orenditë

Do të parapëlqeheshin bankat për dy nxënës me dy karrige të ndara. Nëse do të merrej parasysh opsioni i vendosjes i bankës për një nxënës për shkollat e mesme të larta, reshtet prej tre nxënësve duhet të shmangen.

- 15 deri 18 banka për dy nxënës për vendet urbane dhe 12 banka të nxënësve për vendet rurale ose 30 deri 36 banka për një nxënës në vendet urbane
- Një tabelë shkrimi (e vendosur mundësisht në tre panele lëvizëse) para nxënësve, me një hapësirë minimale prej 2.0 m para rreshtit të parë. Nëse ka nevojë, prapa nxënësve mund të vendoset tabela e dytë shkrimi.
- Tabelë e bardhë lëvizëse;
- Pëlhura për pajisjet audio-vizuale mund të

vendoset në pjesën e sipërme të tabelës së shkrimit;

- Mbajtësja fikse e projektorit në tavan;
- Një tavolinë dhe karrige për personelin mësimdhënës;
- Dollapë për pajisjet dhe materialet pedagogjike.
- Varëse
- Kur ka mundësi buxhetore rekomandohen gardërobat/dollapët për secilin nxënës, të vendosura në korridor në afërsi të dhomave të mësimi (shih shembujt në fig.2-2.2).
- Kur ka mundësi buxhetore rekomandohen dollapë për ruajtjen dhe ekspozimin e punëve të nxënësve të vendosura në dhomën e mësimi (shih shembujt në fig.2-2.2).


(e) Ndriçimi

- Numër i duhur i dritareve për të siguruar sasi të mjaftueshme të ndriçimit natyror. Sipërfaqja e përgjithshme e dritareve duhet të jetë së paku 12% e sipërfaqes së dyshemesë;
- Evitoni kontrastin dhe shkëlqimin që drejtpërsëdrejti vjen nga dielli;
- Sigurimi i ndriçimit të duhur artificial. Parapëlqehen poçet fluoreshentë ekonomik ;


(f) Kushtet për komoditet

- Parapëlqehet orientimi veri jug për t'i ikur rënies së drejtpërdrejtë të diellit tek nxënësit;
- Dhoma e mësimi duhet të jetë larg vendeve të zhurmshme.


Disa shembuj të organizimit të dhomave të mësimi:




DHOMË MËSIMI STANDARDE
Një bankë për dy nxënës, 24
nxënës



DHOMË MËSIMI STANDARDE
Një bankë për dy nxënës, 30 dhe 36
nxënës




DHOMË MËSIMI STANDARDE
Një bankë për dy nxënës, 30
nxënës




DHOMË MËSIMI E ZAKONSHME
Mësimi frontal, 30-36 nxënës
Varianta pa dallapë


Niveli	Tema	Faqe
AB	HB	32




Mësimi "punëtori"
Organizimi i dhomës së mësimit me një
tavolinë për një nxënë, 24,30 ose 36 nxënës




DHOMË MËSIMI E STANDARDE
Mësimi punëtori, 30 - 36 nxënës




Mësimi në grupe
Organizimi i dhomës së mësimit me
një tavolinë për një nxënë




DHOMË MËSIMI STANDARDE
Mësimi në grupe, 30-36 nxënës



Mësimi në grupe
Organizimi i dhomës së mësimit me një tavolinë
për një nxënë 24,30 ose 36 nxënës



DHOMË MËSIMI STANDARDE
Mësimi frontal, 30-36 nxënës
Varianta me dollarë



DHOMË MËSIMI STANDARDE
Mësimi frontal, 30-36 nxënës
Varianta pa dollarë

FIG. 2-2.2

Niveli	Tema	Faqe
AB	HB	34

2.2.5 LABORATORI I SHKENCAVE NATYRORE

(SHIH V2 SHTOJCËN 01 TABELËN U03 DHE R03)

Çdo shkollë e re fillore do e ketë laboratorin për demonstrim për të mësuar shkencat natyrore me një sallë të vogël për përgatitje/deponim.

(a) Aktivitetet

- Mësimdhënia në lëndët shkencore siç është përkufizuar në kurrikulumin zyrtar;
- Ligjëratat, kurset demonstruese, nganjëherë duke i përdorur mjetet audiovizuale, ushtrimet me gojë dhe me shkrim, korrigjimet në tabela shkrimi...[24, 30 ose 36 nxënës].

(b) Plani dhe kapacitetet

Laboratori për shkencat natyrore projektohet për mësimet demonstruese për grupet e tëra të nxënësve prej 36, 30 apo 24 nxënësve; Tavolina e mësimdhënësit duhet të pajiset me lavamanë, rubinete për ujë, gaz, rrymë elektrike dhe me UPS-sa. Kjo tavolinë përdoret nga arsimtarët për demonstrime, prandaj duhet të jetë e vendosur para tabelës së shkrimit dhe të kenë mjaft hapësirë të lirë përreth saj. Përmasat minimale të tavolinës së punës së arsimtarit duhet të jenë 0.8 m x 2.0 m; Kërkesat tjera përfshijnë:

- Tabela e shkrimit duhet të ngjitet në murin ballor dhe mundësisht edhe në murin e pasmë. Duhet të lihet mundësia edhe për ekranin e projektorit;
- Dyert e laboratorëve shkencorë duhet të jenë 1.0 m të gjera dhe duhet të hapen jashtë dhomës. Dera e dytë duhet të jetë e vendosur në pjesën e pasme të laboratorit, me gjerësi të njëjtë, është e këshillueshme të jetë e standardeve më të mëdha për të siguruar evakuimin nga laboratori në rast të ndonjë emergjence. Një derë tjetër do të instalohet

mes laboratorit dhe dhomës së përgatitjes/ruajtjes, në afërsi të tavolinës së punës së arsimtarit.

- Tubacion për largimin e tymit/gazit që parandalon formimin e tij dhe që mundëson zvogëlim të ekspozimit ndaj avujve toksikë, të djegshëm dhe atyre shpërthyes, si dhe ndaj grimcave që rrjedhin si pasojë e procedurave analitike dhe testuese nga laboratori. Duhet të ketë rezistencë të mirë kimike me qëndrueshmëri dhe rezistencë të shkëlqyeshme ndaj tymit dhe avujve të nxehtë.

(c) Kushtet për komoditet

- Ajrosja e mirë është posaçërisht e rëndësishme për pastrim të ajrit dhe për largim të erërave, gazrave dhe të tymrave;
- Kontrollimi i dritës përmes perdeve, parmakëve të dritares, roletneve ose hijeve është i nevojshëm për të mundësuar punë dhe eksperimente precize, atëherë kur ka nevojë për errësi (optike, elektrike...);
- Lartësia e pragjeve të dritares duhet të jetë e mjaftueshme për të parandaluar shkëlqimin e fortë nga tavolinat e punës të vendosura përgjatë dritareve (dhe për të mundësuar që të ketë rubinete të ujit në pjesën e sipërme të tavolinave të punës);
- Zhurmat nga numri i madh i lëvizjeve të nxënësve dhe zhvendosja e oredivëve duhet minimizohet me ndihmën e copëzave të lëmuara të gomës/plastikës të vendosura në dyscheme nën këmbët e stolave dhe të tavolinave.
- Kërkohet lartësia minimale e kthinës minimum 3m (dyscheme-plafon)

(d) Kushtet e sigurisë

Hapësirat ku ruhen materiale shumë të rre-

zikshme ose ku zhvillohen aktivitete me rrezikshmëri të lartë (puna me materie të ndezshme, acide, materiale toksike, instrumente dhe mjete të mprehta, etj.) kërkojnë vëmendje të posaçme me qëllim të mbrojtjes së personave dhe mallrave nga zjarri dhe fatkeqësitë;

- (i) Hapësirat e laboratorëve janë zona me rrezikshmëri të lartë dhe duhet të mbrohen **nga zjarri**:
- Materialet e ndezshme duhet të mbahen larg tavolinave të punës së nxënësve;
 - Largimi i tymit duhet të bëhet përmes dritareve të larta ose tërthore ose përmes ajrosjes mekanike (përveç tubacionit për largim të tymit/gazit);
 - Pajisjet për shuarjen e zjarrit (kryesisht aparati për shuarje të zjarrit) duhet të sigurohen nëpër laboratorë dhe dhoma të përgatitjes (përveç pajisjeve të tjera që instalohen në hapësirat e qarkullimit);
- (ii) Mbrojtja nga **rreziku nga fatkeqësitë** po ashtu është masë e rëndësishme për laboratorë:
- Për mirëmbajtje më të lehtë, rrjeti elektrik, gypat e ujit dhe të gazit mund të instalohen nëpër mure, nën tavolinat e punës me një mbrojtje efikase të konstruktit me këllëf.
 - Duhet të mbahet largësia minimale prej 1.0 m ndërmjet burimit të ujit (rubineteve) dhe prizave elektrike;
 - Duhet të ketë qasje të lehtë në kutinë shpërndarëse të energjisë elektrike, të instaluar në mur prapa arsimtarit (ose në dhomën e përgatitjes) dhe të jetë e mbyllur në një kuti të kyçur. Duhet të shtohet një çelës elektrik i pavarur për fikje, me ndërprerës për raste emergjencash.
 - Duhet të sigurohen dritat emergjente për të

shmangur aksidentet në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike gjatë eksperimenteve nga mësimdhënësi.

(e) Kushtet teknike

- (i) Mbulesat e sipërfaqeve
- Lavamanët duhet të jenë të punuar nga materiali që pastrohet lehtë dhe është rezistent ndaj acideve; dhe
 - Tavolinat e punës duhet të mbrohen me pllaka mbuluese që u rezistojnë kemikaljeve dhe goditjeve.
- (ii) Tubacionet
- Shmangni sa më shumë që mundeni tubacionet e fiksuara dhe mundësoni qasje të lehtë për mirëmbajtje dhe riparime; dhe
 - Tubacionet shkarkuese duhet të ajrosen, të jenë rezistuese ndaj produkteve acidike dhe të kenë një pjerrtësi prej 1 deri 2% për largim të lehtë të tyre.
- (iii) Furnizimi me gaz
- Rekomandohen cilindra portativ të gazit: janë ekonomik, të sigurt dhe të lehtë për t'u instaluar;
 - Deponia cilindrike për ruajtjen e gazit është e pranueshëm vetëm për dy cilindra. Ai duhet të vendoset në një kthinë të posaçme për ruajtje, që është e vendosur afër dhomës së përgatitjes dhe me derë të përshtatshme kundër zjarrit me qasje në korridor.
- (iv) Furnizimi me energji elektrike
- Instalimi i telave duhet të jenë të mbrojtur me këllëf;
 - Sistemi i furnizimit duhet të mundësojë kërkesat për rritje të mëtejme të nevojave për energji për pajisjet e reja.

(f) Orenditë dhe pajisjet


Artikujt specifik për laboratorët e shkencave

Niveli	Tema	Faqe
AB	HB	36


natyrore janë:

- Bankat e zakonshme për dy ose një nxënës dhe karriget për nxënës;
- Kabinete rezistente ndaj acideve për ruajtje të gjësendeve;
- Tavolina me rrotëza;
- Aparatet për shuarje të zjarrit dhe kompleti i ndihmës së parë;
- Kompjuterët dhe pajisjet përcjellëse;
- Pajisjet multimediale;
- Pajisjet laboratorike për mësimdhënie në shkencat natyrore në nivelin fillor.

LABORATORI I NIVELIT FILLOR



LABORATORI I NIVELIT FILLOR
24 nxënës



LABORATORI I NIVELIT FILLOR
30 dhe 36 nxënës

Dhoma e përgatitjes shfrytëzohet nga një laborator




FIG. 2-2.3

LABORATORI I NIVELIT FILLOR
30 dhe 36 nxënës

Shembull - Shkolla Model në Prishtinë




FIG. 2-2.4

DHOMA E PËRGADITJES
Për dy laboratorë

Niveli	Tema	Faqe
AB	HB	38

2.2.6 ZYRA E DREJTORIT DHE E SEKREтарIT

- (a) **Aktivitetet** përfshijnë punët rreth menaxhimit të shkollës, punët administrative, takimet e personelit, takimet me prindër, menaxhimin me dokumente, klasifikimin dhe vendosjen e tyre nëpër dosje.
- (b) **Plani:** Sekretaria duhet të jetë drejtpërdrejtë e lidhur me zonën për pritje dhe zyrën e drejtorit. Dhomat e përfshira në këtë hapësirë janë zyra e drejtorit, sekretaria me hapësirë të vogël për pritje, depoja dhe tualetet e personelit dhe të vizitorëve. Shkollat e vogla fillore që gjenden në viset rurale apo ato me densitet të ulët (paralelet e ndara), nuk kanë fare sekretar prandaj është vetëm një zyrë.
- (c) **Kushtet për siguri:** zyrat kërkojnë mbrojtje të mirë kundër vjedhjeve dhe vandalizmave. Këto kushte përfshijnë:
- (i) Dyer të sigurta të cilësisë së lartë;
 - (ii) Dritare të sigurta të cilësisë së lartë (në raste specifike rekomandohen mbrojtje të dritareve me grila prej metali)
 - (iii) Dollapë dhe kabinete me dry të fortë;
- (d) **Orenditë dhe pajisjet:**
- Kompjuterë, lidhje në internet, rrjeti i kabllove dhe/apo sistemin *wifi*, skaner, printerë;
 - Raftet e librave, kabinete të dosjeve, dollapë,;
 - Tryeza, kolltukë, karrige;
 - Rrjet të telefonit (linja të brendshme dhe të jashtme, makinë të faksit);
 - Makinë për fotokopjim

2.2.7 SALLA E ARSIMTARËVE

- (a) **Aktivitetet**
- Salla e arsimtarëve duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme për këto veprimtari:
- (i) Punën arsimore: përgatitja e lëndëve, takime;
 - (ii) Kompjuterë, lidhje në internet, rrjeti i kabllove dhe/apo sistem *wifi*;
 - (iii) Pushim dhe diskutim në mes të personelit;
 - (iv) Ruajtjen e gjërave dhe materialeve personale të mësimeve, dhe
 - (v) Për ngrënie
- (b) **Plani dhe hapësira**
- Sipërfaqja e përgjithshme për sallat e arsimtarëve dallon varësisht nga numri i mësimeve. Megjithatë, në planet e akomodimit (detyrat projektuese), për secilin mësime është caktuar hapësira mesatare prej 2,5 m². Salla është e ndarë në dy pjesë: (i) hapësira e punës për përgatitjen e lëndëve dhe të njësive mësimore dhe për diskutime dhe takime mes mësimeve; (ii) hapësira për ruajtjen e gjërave të mësimeve dhe për pushim.
- (c) **Pozicionimi**
- Pozicionimi i sallës së arsimtarëve duhet të jetë afër zyrës së drejtorit dhe të sekretarit me qasje të lehtë për nxënësit në mënyrë që ata të mund të vijnë dhe të bëjnë pyetje, të marrin kopje, etj.
- (d) **Pajisjet dhe orenditë**
- Pajisjet dhe orenditë përfshijnë tavolinat, karriget, tabelat për shkrim, dollapët, raftet dhe tabelat e njoftimeve.

2.2.8 BIBLIOTEKA

(SHIH DIAGRAMIN E LIBRARISË FIG. 2-4.6 MË POSHTË)

(a) Aktivitetet

Aktivitetet që mund të kryhen në bibliotekë dhe në qendrën mediale janë: (i) leximet individuale nga nxënësit dhe mësime të përbashkëta; (ii) aktivitete arsimore në grupe të vogla (kërkimet dhe studimet kolektive, kritikën letrare ...); (iii) qasja në internet; (iv) marrja e librave nga biblioteka; (v) vendosja e etiketave, vendosja nëpër raftet, shpërndarja dhe huazimi i librave.

Hapësira e bibliotekës së shkollës gjithashtu duhet të akomodojë mësimin me kompjuter që është ndarë nga leximi i qetë dhe aktivitetet tjera mësimore.

(b) Plani dhe kapacitetet

(i) Projektimi dhe plani

Fleksibiliteti për sa i përket projektimit është tejet i rëndësishëm për të mundësuar kryerjen e aktiviteteve të shumfishta dhe për të akomoduar ndryshimet e ardhshme të kurrikulit dhe atyre të teknologjisë. Projektimi gjithashtu duhet të mundësojë mbikëqyrjen e lehtë të bibliotekistit dhe të mësimeve të përbashkëta përmes rrjedhës efikase të lëvizjeve, për të minimizuar pengesat. Kontrollimi i daljeve gjithashtu është i rëndësishëm: rekomandohet një numër minimal i daljeve për një siguri dhe rrjedhë të qetë të lëvizjeve.

Biblioteka është qendër aktive e mësimnxënies dhe duhet të mundësojë akomodimin e aktiviteteve udhëzuese të shumfishta në të njëjtën kohë. Zonat specifike të bibliotekës duhet të përfshijnë:

- Një zonë të hyrjes me:
 - Këndin e recepsionit me hapësirë të mjaftueshme për çanta;
 - Zyrën e vogël të bibliotekistit me një tavolinë të pranimit;
 - Referencat bibliografike dhe të përgjithshme;
- Pjesa e depozitave dhe të rafteve:
 - Depo e librave me dhomën e rafteve dhe të procesimit;
 - Raftet për pajisje;
 - Këndi i ekspozimit;
- Këndi i leximit dhe qendrën mediale
 - Hapësirat e qeta të mësimit/rekreacionit për nxënësit dhe mësime të përbashkëta;
 - Hapësirat audio-vizuale (TV, DVD etj.);
 - Këndi i kompjuterëve/teknologjisë;
- (ii) . **Pozicionimi, kapaciteti dhe madhësia**
 - Biblioteka duhet të vendoset në katin përdhës, dhe të jetë e kthyer kah veriu;
 - Numri i librave që duhet të vendosen në raftet përkufizohet nga MASH-T-i në bazë të koleksioneve standarde të bibliotekave të shkollave;
 - Kapaciteti i bibliotekës dhe i qendrës mediale është llogaritur për numrin fikse të nxënësve të dy klasave (48 nxënës në viset me densitet të ulët dhe 72 nxënës për viset me densitet të lartë) që vijojnë bibliotekën në një kohë të caktuar dhe njësia e sipërfaqes është 1,5 m² për një nxënëse;
 - Shkollat e vogla fillore që gjenden në viset rurale apo ato me densitet të ulët (palelet e ndara), nuk kanë fare sallë të bibliotekës.

(c) Punët përfundimtare

- Dyshemetë: Tepihë, dysheme druri apo të lëmueshme;
- **muret:** e ngjyrosura ose të veshura me

Niveli	Tema	Faqe
AB	HB	40

materiale të qëndrueshme në goditje; **tavanet**: pllaka akustike për kohë të shkurtër të jehonës;

- ngjyra: të ngrohta, ngjyra të ndritshme.

(d) Pajisjet dhe orenditë

- Raftet për libra dhe revista;
- Tabela për shpallje të vendosura në mure;
- Banaku i bibliotekistit dhe raftet për broshura, formularë etj
- Kutia e kartelave (dollarë të vegjël)
- Tavolina për ekspozimin e revistave e dizajnuar me kujdes me sipërfaqe të qëndrueshme, ngjyra të ndritshme dhe e përshatshme për madhësinë e nxënësve;
- Karriget e ulëta komode me tavolina të ulëta të përshtatshme për lexime të rastit, sipas madhësisë së nxënësve;
- Kompjuterët për nxënësit, mësimdhënësit dhe bibliotekistin, të pozicionuar ashtu që shmangë shkëlqimin e dritës;
- Hapësirë pune që përshtatet sipas nevojës, me platformë të rrafshët për mbajtje të shënimeve;
- Pajisje të TI-së, që përfshijnë skanerët, printerët...
- Pajisjet audiovizuale (DVD, LCD, TV, projektor të lartë, ekran, etj).
- Makinë të fotokopjimit

(e) Kushtet e sigurisë

- Vjedhja dhe vandalizmi:** duhet të ndërmerren masa për mbrojtjen e dokumenteve dhe të pajisjeve. Këto masa përfshijnë:
 - Vetëm një hyrje/dalje përmes një dore të fortë me dry të sigurisë së lartë;
 - Vëzhgim të lehtë të hyrjeve dhe të hapësirave të brendshme;

- Raftet në hyrje për çantat e shkollës;
- Mbrojtja e dokumenteve** duhet të bëhet përmes:
 - Izolimit kundër frymës dhe pluhurit;
 - Ajrosjes kundër efekteve dëmtuese nga lagështia;
 - Mbrojtjes kundër dritës së diellit: nëse orientimi nga veriu nuk është i mundur, në dritare duhet të vendosen kanatat, perdet dhe hijezueset;

2.2.9 HAPËSIRA (SALLA) QË PËRDORET PËR SHUMË QËLLIME

(a) Aktivitetet

Hapësira (Salla) për qëllime të shumëfishta shërben për mbajtjen e aktiviteteve të parapara me kurrikulum dhe për aktivitete rekreative dhe luan rol qëndror për takime të shkollës dhe komunitetit. Kjo sallë duhet të shërbejë për aktivitetet si në vijim:

- Organizimet muzikore dhe teatrale, shfaqjen e filmave dhe kuvendet e përgjithshme të organeve të nxënësve. Këto organizime kërkojnë hapësirë të madhe qendrore, ndërsa publiku duhet të ulet nëpër rreshta, përballë skenës ose ekranit;
- Sportet dhe lojërat që mbahen kryesisht në kohë të dimrit, ekspozitat, mësimdhëniet në punëtori. Këto organizime kërkojnë hapësirë të madhe qendrore dhe të hapur, ndërsa publiku duhet të ulet përgjatë mureve apo të kenë mundësinë e qarkullimit të lirë;
- Takimet e komunitetit lokal, prezantimet, interpretimet dhe takimet për shoqatat e prindërve dhe të mësimdhënësve.

(b) Plani dhe kapacitetet

- Kapaciteti dhe sipërfaqja:** sipërfaqja është

llogaritur në proporcionin prej 0.50 m² për nxënë, për tërë kapacitetin e shkollës, duke pasur parasysh se numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të shkollës do të mbledhet njëherë ose dy herë në vit.

- (ii) **Anekset:** Salla për shumë qëllime mund të ketë anekset siç janë kuzhina, salla për përgatitjen e arsimitarëve me dollapë dhe tualete, depo, holl (në hyrjen kryesore), korridorin hyrës, galeri për spektatorë, etj.
- (iii) **Pozicionimi:** Disa opsione janë të pranueshme. Për shembull, nëse vendoset afër hyrjes kryesore, kjo do të mundësonte shfrytëzimin e hapësirave të recepsionit, ndërsa vendosja afër fushave të lojës do të mundësonte shfrytëzimin e aktiviteteve në atë vend.
- (iv) **Fleksibiliteti:** projektuesi do të përballë me sfidën sa i përket akomodimit të numrit të madh të aktiviteteve të llojllojshme. Për këtë arsye, plani duhet të jetë shumë fleksibil dhe të mundësojë përshtatjen për disa veprimtari të ndryshme të cilat mund të mbahen në të njëjtën kohë apo njëra pas tjetrës. Struktura duhet të projektohet në atë mënyrë që të mos nevojitet asnjë shtyllë në mes të kësaj hapësire, ndërsa tavani duhet të jetë mjaft i lartë për të mundësuar lojërat me topa të vegjël.
- (v) **Pajisjet e fiksuara** duhet të shmangen sa më shumë që të jetë e mundur. Skena për shfaqje teatrale duhet të jetë prej njësive të vogla të platformës të cilat mund të rirregullohen nga nxënësit për t'u përdorur për veprimtari të tjera.

(c) Kushtet për komoditet

- (i) **Akustika:** shumë prej aktiviteteve që mbahen në sallën për qëllime të shumëfishta janë të zhurmshme, andaj hapësira duhet të ketë

izolim të mirë të zërit dhe duhet t'i posedojë masat e zvogëlimit të jehonës;

- (ii) **Ndriçimi:** salla duhet të ofrojë mundësinë e errësimit për disa veprimtari të caktuara siç janë produksionet e filmave, shfaqjet teatrale, etj.
- (iii) **Ajrosja:** ajrosja e vazhdueshme së bashku me ngrohjen e duhur të sallës janë thelbësore.

(d) Punët përfundimtare

- (i) **Dyshemetë:** shtresat jo të lëmueshme, shtresat jo të rrëshqitshme.
- (ii) **muret:** lloje të ndryshme të shtresave të sipërme për variacione akustike, pra pllaka gipsi të ngjyrosur, panelet prej druri, rripat prej druri me absorbim akustik, shpërplakë;
- (iii) **tavanet:** forma dhe punët përfundimtare të tyre duhet të kenë efektin e dëshirueshëm akustik, pra pllaka gipsi të ngjyrosur, pllaka akustike, rripa prej druri me absorbim akustik, shpërplakë;
- (iv) **ngjyra:** ngjyra të ngrohta apo neutrale dhe materiale natyrore me pëlthura të ndritshme dhe murale;

(e) Orenditë dhe pajisjet

Nevojat për sa i përket orendive mund të ndikohen nga llojllojshmëria e funksioneve. Kjo përfshinë (i) karrige komfore të veshura me susta dhe të palosshme me njëra tjetrën dhe (ii) skena të bëra nga kutitë apo platformat modulare për të mundësuar fleksibilitet.

Pajisjet, duhet të përfshijnë së paku: (i) sistemin e zërimit; (ii) pajisjet audiovizuale dhe ekranin, tabelat e bardha, tapetat për gjimnastikë dhe pajisjet e tjera sportive (shihni sallën e sportive).

(f) Kushtet teknike

Salla e cila përdoret për qëllime të shumëfishta

DIAGRAMI FUNKSIONAL I HAPËSIRËS (SALLËS) PËR PËRDORIM PËR QËLLIME TË NDRYSHME




FIG 2-2.5

duhet të akomodojë kërkesa që shpeshherë janë kontradiktore që korrespondojnë me veprimtari të ndryshme siç janë auditoriumet dhe aktivitetet e gjimnastikës: (i) aktivitetet e gjimnastikës kërkojnë një sipërfaqe të madhe të hapësirës së zbrazët për vendosjen e pajisjeve sportive, siç janë pajisjet për kërcimin me kuaj, shufrat nëpër mure dhe dyshek, si dhe një depo për këto pajisje; (ii) aktivitetet e auditoriumit kërkojnë trajtim të posaçëm akustik, perde të errëta për shfaqje të filmave, depo për karrige....

2.2.10 MJEDISËT SANITARE

(a) Mjediset sanitare për nxënës

Pjesa e tualeteve për nxënës do të jetë e vendosur brenda shkollës ku zhvillohet mësimi (p.sh. një pjesë për tualete në fund të çdo kati), mund të vendosen edhe të tjera të kombinuar me oborrin për lojërë, ku do të shërbente si për dhoma të mësimi, ashtu edhe për oborrin e lojërave.

(i) WC:

- Nevojiten WC të ndarë për djem dhe për vajza, me qasje të ndarë;
- Hapësirat minimale për WC janë 1.40 m x 0.90 m, nëse dera hapet jashtë, dhe 1.50 m x 0.90 m, nëse dera hapet brenda;
- Numri minimal i WC-ve është 1 për 30 nxënës;
- WC-të duhet të jenë të pajisura me tualete, të përshtatura me gjatësinë e fëmijëve.
- Çdo shkollë do të ketë së paku një kabinë tualeti me dimensione specifike, qasje dhe pasje për fëmijët me nevoja të veçanta (shih vëllimin një, paragrafin 3.8.1 dhe 3.8.2).
- Kurë ka mundësi buxhetore rekomandohet shpëlarja me ujin e mbledhur atmosferik.

(ii) Lavamanët:

- Duhet të jenë të vendosura afër hapësirës për WC;
- Të instaluar në lartësinë e duhur me atë të fëmijëve;
- Instalimet dhe krojet të jenë të fiksuara fort.
- Kurë ka mundësi buxhetore rekomandohen krojet të furnizohen edhe me ujë të nxehtë.

(iii) Kushtet për komoditet:

- Kërkohet ajrosja natyrale, ndërsa rekomandohet ajrosja mekanike;
- Kërkohet mbrojtja kundër rrezeve të tepërta të diellit për t'iu shmangur nxehtësisë dhe lagështisë.
- Kërkohet lartësia minimale e kthinës minimum 3m (dysHEME-plafon)

(iv) Kushtet teknike:

- Kontrolli i ujit: rekomandohen sisteme të krojeve dhe të shpëlarjes me kontroll automatik të vaskave me qëllim të zvogëlimit të humbjes së ujit;
- Duhet të instalohen sistemet e duhura të kulimit të ujit, të sifoneve dhe të pastrimit;
- Instalimet e sanitarisë duhet të përzgjidhen në bazë të cilësisë së mirë dhe qëndrueshmërisë afatgjatë;
- Zonat për qasje të riparuesve dhe mirëmbajtësve, si dhe tavanet e ulura janë të domosdoshme për riparime dhe mirëmbajtje;
- Sipërfaqet e sipërme të mureve dhe të dysHEMEVE duhet të pastrohen lehtë (pallakat e qeramikes për dysHEME dhe pallakat e porcelanit për mure (deri në 2.20 m);
- Hapësirat duhet të jenë të projektuara në atë mënyrë që të mundësojnë pastrim dhe mirëmbajtje të lehtë.

DIAGRAMI FUNKSIONAL I OBJEKTEVE SANITARE




FIG. 2-2.6

(b) Hapësirat sanitare për punonjësit administrativ dhe për mësimdhënës

- (i) **WC:**
- WC të ndara për meshkuj dhe për femra, me hyrje të ndara;
 - Dimensionet minimale të hapësirës për WC janë 1.60 m x 1.00 m ;
 - Numri minimal i WC-ve është 1 për 15 persona;
 - Kurë ka mundësi buxhetore rekomandohet shpëlarja me ujin e mbledhur atmosferik.

(ii) Lavamanët:

- Duhet të jenë të vendosura afër hapësirës për WC;
- Një lavaman duhet të jetë për çdo WC;
- Rekomandohet krua me ujë të nxehtë dhe të ftohtë.

(c) Hapësirat sanitare për punonjësit jomësimdhënës

Këto hapësira duhet të jenë të vendosura afër pjesës administrative. Ato duhet të jenë të qasshme përmes hapësirave për qarkullim të përbashkët.

2.2.11 HAPËSIRAT PËR QARKULLIM

Hapësirat për qarkullim përfshijnë korridoret, shkallët, hollet, galeritë dhe hollet hyrëse. Ato shfrytëzohen nga nxënësit, punonjësit dhe nga mysafirët për qarkullimin e tyre mes dhomave të mësimi dhe zyrave, mes hapësirave, si dhe mes niveleve e ndërtesave të ndryshme. Përveç kësaj, ato janë menduar për shfrytëzim (i) për evakuim në rast zjarri apo të katastrofave natyrore dhe (ii) për vendosjen e dollapët e nxënësve në zonat ku ato nuk zënë hapësirat për evakuim sipas rregullores për mbrojtje nga zjarri. Këto hapësira duhet të projektohen, ndërtohen dhe të pajisen duke marrë parasysh funksionalitetin, sigurinë dhe duhet të jenë në përputhje me rregullat për mbrojtje nga zjarri. Për të lehtësuar mirëmbajtjen nga stafi i shkollës, sipërfaqet e sipërme të murit në vendet për qarkullimin e nxënësve duhet të jenë rezistente dhe të pastrueshme deri në lartësinë prej 1.60 m.

Sipërfaqja për qarkullim paraqet rreth 21 deri në 25% të sipërfaqes së përgjithshme të shkollës.

Çdo hapësirë e qarkullimit llogaritet në bazë të numrit të shfrytëzuesve, me hapësira të kalimit prej 0.60 m që përputhen me kalimin e 50 personave. Hapësira minimale e korridoreve të shkollës është 1.60 m për deri në 100 persona (shih tabelën 3.0 më poshtë).

■ GJERËSIA MINIMALE PËR QARKULLIM

Numri i nxënësve	Njësitë	Gjerësia (m)
<50	1	1.60
50 to 100	2	1.60
100 to 200	3	1.80
200 to 300	4	2.40
300 to 400	5	3.00
400 to 500	6	3.60
500 to 600	7	4.20
600 to 700	8	4.80

TABELA 3.0



3



3. HAPËSIRAT E BRENDSHME PËR NDËRTESAT SHKOLLORE TË ARSIMIT BAZIK (THEMELOR)

Në Kosovë, arsimi është i obligueshëm nga klasa e parë gjer në klasën e nëntë (arsimi bazik) dhe ndërtesat shkollore ekzistojnë për këto klasa edhe pse janë të pamjaftueshme për shkallën e tashme të regjistrimit. Për tu përballur me këtë mungesë të ndërtesave, nxënësit vijnë në mësimin në dy, tri ndërrime.

Shkollat e arsimit bazik ofrojnë mësimnxënien nga klasa e parë gjer në klasën e nëntë për tri nivele të arsimit:

- (a) Arsimi parafillor: 1 vit, klasa 0, mosha 5 vjeç;
- (b) Arsimi fillor: 5 vite, klasa 1 deri 5, mosha 6 deri 10 vjeç;
- (c) Arsimi i mesëm i ulët: 4 vite, klasa 6 deri 9, mosha 11 deri 14 vjeç;

Në shkollat e reja, sistemi i ndërrimeve të kufizohet në më së shumti dy ndërrime dhe se nxënësit e çdo niveli të vijnë në mësimin në ndërtesat e njëjta. Si rezultat, shkollat e reja të arsimit bazik do të kenë hapësirat specifike mësimore për çdo nivel. Sidoqoftë, disa nga hapësirat administrative dhe të shërbimit shfrytëzohen bashkërisht nga niveli fillor dhe i mesëm i ulët.

Prandaj propozohet për shkollat e arsimit bazik që tri nivelet e arsimit të vendosen në lokacionet e njëjta me hapësira të ndryshme, përveç për zyrat e administratës, sallën për shumë qëllime, bibliotekën, kantinën dhe objektet për sport (shih shembullin i diagramit funk-

sional Fig. 2-3.1 gjer 2-3.3 më poshtë). Përveç kësaj, dizajni i atyre shkollave bëhet në atë mënyrë që në të ardhmen, këto shkolla të mund të ndahen plotësisht me ndryshime minimale.

Ky udhëzim propozon katër shkolla standarde të arsimit fillor përfshirë dy për viset me densitet të ulët dhe dy tjera për shkollat standarde me densitet të lartë (shih tabelën 3-1 më poshtë). Lista e hollësishme e ndërtesave me sipërfaqet korresponduese janë treguar në shtojcën 2-01.

SHKOLLAT STANDARDE TË ARSIMIT BAZIK KLASAT DHE NXËNËSIT

Niveli i ar- simit	Numri	VISET ME DENSITET TË ULËT				VISET ME DENSITET TË LARTË					
		2		3		2		3		4	
	i	Klasave	Nxënës	Klasave	Nxënës	Klasave	Nxënës	Klasave	Nxënës	Klasave	Nxënës
Parafillor	1	2	48	3	72	2	72	3	108	4	144
Fillor	5	10	240	15	360	10	360	15	540	20	720
Mesëm i ulët	4	8	192	12	288	8	288	12	432	16	576
Gjithsej	10	20	480	30	720	20	720	30	1080	40	1440

TABELA 2.4

Të gjitha ndërtesat e shkollave të arsimit bazik do të kenë madhësinë dhe kërkesat e njëjta me ato të përshkruara në kapitullin 2 për nivelet parafillore dhe fillore

dhe në kapitullin 4 për nivelet e mesme të ulëta. Për objektet e përbashkëta, projektuesit i referohen kërkesave nga kapitulli 5.

DIAGRAMI FUNKSIONAL I SHKOLLËS SË ARSIMIT BAZIK PARAQITJA HORIZONTALE





FIG. 2-3.1

SHKOLLA E ARSIMIT BAZIK DIAGRAM FUNKSIONAL (1) PARAQITJA VERTIKALE



SHKOLLA E ARSIMIT BAZIK DIAGRAM FUNKSIONAL (2) PARAQITJA HORIZONTALE




FIG. 2-3.2 DHE 2-3.3



4



4. HAPËSIRAT E BRENDSHME TË SHKOLLAVE TË MESME TË ULËTA DHE TË LARTA

4.1 HAPËSIRAT PËR MËSIM

4.1.1 DHOMA E MËSIMIT

(SHIH V2 SHTOJCËN 02 TABELËN U01 DHE R01)

(a) Aktivitetet

- Mësimdhënia e lëndëve të përgjithshme, ashtu siç është përcaktuar në kurrikulumin e përgjithshëm, siç janë gjuhët, matematika dhe lëndët e tjera.
- Ligjëratat; demonstrimet, duke përdorur nganjëherë pajisjet audiovizuale; ushtrimet me gojë dhe me shkrim, korrigjimet në tabelën e shkrimit, etj;
- Puna në grupe, kurset interaktive; Mësimi plotësues, dhoma e mësimit mund të shfrytëzohet për aktivitete jashtëmësimore, siç janë konferencat, mbledhjet, shkolla të natës, aktivitetet socio-kulturore, etj

(b) Plani dhe kapaciteti

Për nivelin e mesëm të ulët dhe të lartë, kapaciteti i klasave është 24 fëmijë për densitet të ulët apo vise rurale dhe 30 deri 36 fëmijë për densitet të lartë apo vise urbane, dhe hapësirat e sugjeruara për nxënës janë 1.6 m² dhe 1.9 m² me hapësirë të njëjtë për çdo nxënës në të tri rastet. Madhësia, forma dhe fleksibiliteti i hapësirave të


mësimi janë faktorë kyçë në krijimin e mjedisit pozitiv të mësimi. Kushtet ku mësimi zhvillohet në hapësira të tejmbushura, me hapësira tepër të vogla për nxënës, ku rrjedhimisht ata nuk do të jenë në gjendje të ballafaqohen me stile të ndryshme të mësimdhënies, janë një nga shkaqet kryesore të shqetësimit përkitazi me projektimin e dhomave të mësimi.

- Bankat nuk duhet të jenë shumë afër njëra-tjetrës, dhe duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme që nxënësit të lëvizin lirshëm;
- Hapësira për lëvizje përfshinë: (i) qarkullimin që ia mundëson mësimdhënësit qasjen e shpejtë tek nxënësi pavarësisht planit të dhomës së mësimi; (ii) hapësirën për qëndrim prapa secilit nxënës me qëllim të diskutimit të punës së tyre; dhe (iii) hapësirën personale.


(c) Punët përfundimtare

- Dysheme të lëmueshme;
- Mure të ngjyrosura ose të veshura me pllaka gipsi të qëndrueshme në goditje;
- Tavane të veshura nga pllakat akustike me kohë të shkurtër të jehonës;
- Ngjyra me tonalitete mesatar me qëllim të zvogëlimit të kontrastit dhe shkëlqimit, me faktor të mjaftueshëm të reflektimit.

Niveli	Tema	Faqe
MU/ML	HB	56




DHOMË MËSIMI E ZAKONSHME
Mësimi frontal, 30-36 nxënës
Varianta me dollapët



DHOMË MËSIMI E ZAKONSHME
Organizimi për punëtori, 30 -36 nxënës

FIG. 2-4.1



DHOMË MËSIMI E ZAKONSHME
Mësimi në grupe, 30-36 nxënës

(d) Pajisjet dhe orenditë

Në nivelin e mesëm të ulët mund të përdoren bankat për dy nxënës me dy karrige të ndara gjithashtu rekomandohet dhe opsioni i vendosjes i bankës për një nxënës me një karrige të ndarë por, në këtë rast duhet të shmangen reshtet prej tre nxënësve.

- 15 deri 18 banka për dy nxënës për vendet urbane dhe 12 banka të nxënësve për vendet rurale;
- Mundësisht 30 deri 36 banka shkollore për shkollat e mesme të larta;
- Një tabelë shkrimi (e vendosur mundësisht në tri panele lëvizëse) para nxënësve, me një hapësirë minimale prej 2.0 m para rreshtit të parë. Nëse ka nevojë, prapa nxënësve mund të vendoset tabela e dytë.
- Ekrani për pajisjet audio-vizuale mund të vendoset në pjesën e sipërme të dërrasës së zezë;
- Një tavolinë dhe karrige për personelin mësimdhënës;
- Dollapë për pajisjet dhe materialet pedagogjike.
- Varëse ose dollapë për ruajtjen dhe ekspozimin e punëve të nxënësve.

(e) Ndriçimi

- Numër i duhur dritarësh për të siguruar sasi të mjaftueshme të ndriçimit natyror. Sipërfaqja e përgjithshme e dritareve duhet të jetë së paku 12% e sipërfaqes së dyshemesë ;
- Evitoni kontrastin dhe shkëlqimin që drejtpërsëdrejti vjen nga dielli;
- Sigurimi i ndriçimit të duhur artificial. Parapëlqehen poqet fluoreshentë ekonomik;

(f) Kushtet për komoditet

- Parapëlqehet orientimi veri jug për t'i ikur

rënies së drejtpërdrejtë të diellit tek nxënësit;

- Dhoma e mësimit duhet të jetë larg vendeve të zhurmshme.
- Kërkohe lartësia minimale e kthinës minimum 3m (dysHEME-plafon)
-

4.1.2 DHOMAT E MËSIMIT - SPECIFIKE

(SHIH V2 SHTOJCËN 02 TABELËN U02 DHE R02)

(a) Aktivitetet

Aktivitetet kryesore të dhomës specifike të mësimit përfshijnë:

- Mësimdhënien e lëndëve specifike sipas kurrikulumit zyrtar, siç janë gjeografia, historia dhe lëndët e tjera;
- Ligjëratat; demonstrimet, duke përdorur nganjëherë pajisjet audiovizuale; ushtrimet me gojë dhe me shkrim, korrigjimet në tabelën e shkrimit, etj;
- Puna në grupe, kurset interaktive

(b) Plani dhe kapaciteti

Plani i dhomës specifike të mësimit është shumë i ngjashëm me atë të dhomës së zakonshme të mësimit. Megjithatë, nxënësit kanë hapësirë shtesë për t'u grumbulluar përreth tavolinës së mësimdhënësit, dhe rendi i raftëve shtesë do të montohet në pjesën e pasme ose anësore të dhomës së mësimit për vendosjen e materialeve pedagogjike, siç janë hartat, globet, etj...

(c) Punët përfundimtare

- DysHEME të lëmueshme;
- Mure të ngjyrosura ose të veshura me pllaka gipsi të qëndrueshme në goditje;
- Tavane të veshura nga pllakat akustike me kohë të shkurtër të jehonës;
- Ngjyra me tonalitete mesatar me qëllim të

Niveli	Tema	Faqe
MU/ML	HB	58

zvogëlimit të kontrastit dhe shkëlqimit, me faktor të mjaftueshëm të reflektimit.

(d) Pajisjet dhe orenditë

- Në dhomën specifike të mësimit mund të përdoren bankat për dy nxënës me dy karrige të ndara gjithashtu rekomandohet dhe opioni i vendosjes i bankës për një nxënës me një karrige të ndarë por, në këtë rast duhet të shmangen reshtet prej tre nxënësve.
- 15 deri 18 banka për dy nxënës për vendet urbane dhe 12 banka të nxënësve për vendet rurale;
- Mundësisht 30 deri 36 banka shkollore për shkollat e mesme të ulëta dhe të larta;
- Një tabelë shkrimi (e vendosur mundësisht në tre panele lëvizëse) para nxënësve, me një hapësirë minimale prej 2.0 m para rreshtit të parë. Nëse ka nevojë, prapa nxënësve mund të vendoset tabela e dytë.
- Ekrani për pajisjet audio-vizuale mund të vendoset në pjesën e sipërme të tabelës së shkrimit;
- Një tavolinë dhe karrige për personelin mësimdhënës;
- Një raft për pajisjet dhe materialet pedagogjike (ose raft i montuar).
- Tre dollapë për pajisje dhe materiale pedagogjike.

(e) Ndriçimi

- Numër i duhur dritarësh për të siguruar ndriçimi të mjaftueshëm natyror. Sipërfaqja e përgjithshme e dritareve duhet të jetë së paku 12% e sipërfaqes së dyshemesë);
- Evitoni kontrastin dhe shkëlqimin që drejtpërsëdrejti vjen nga dielli;
- Sigurimi i ndriçimit të duhur artificial. Parapëlqehen poçet fluoreshentë ekonomik;

(f) Kushtet për komoditet

- Parapëlqehet orientimi veri jug për t'i ikur rënies së drejtpërdrejtë të diellit tek nxënësit;
- Dhoma e mësimit duhet të jetë larg vendeve të zhurmshme.
-

4.1.3 LABORATORI I GJUHËS

(SHIH V2 SHTOJCËN 02 TABELËN U03 DHE R03)

(a) Aktivitetet

Laboratori i gjuhës përmban pajisjet e veçanta audiovizuale për të ndihmuar nxënësit që të mësojnë gjuhët e huaja duke dëgjuar trakët apo CD-të, duke parë video, duke incizuar veten, etj. Nxënësve iu jepet mundësia për të praktikuar duke dëgjuar audio programet dhe duke parë videoklipe.

Teknikisht, laboratori i gjuhës është mjet teknologjik për mësimdhënie që përbëhet nga njësia burimore që mund t'i shpërndajë nxënësve materiale audio, audiovizuale dhe të shkruara, me llojllojshmëri të madhe të mekanizmave për komentim në mes të nxënësve dhe mësimdhënësve.

Përparësitë e atij sistemi përfshijnë:

- Shqiptimin, aksentin dhe rrjedhshmërinë në të folur që mund të përvetësohet në mënyrë efektive;
- Mjetet për të caktuar mësimet dhe seancat për tërë vitin akademik;
- Nxënësit mund të pranojnë automatikisht mësimet nga burimi kryesor përmes leximit të mësimëve për të bërë praktikë personale;
- Opsionet për të dëgjuar nxënësit një nga një
- Vëmendje të veçantë për çdo nxënës, pa




FIG. 2-4.2

Niveli	Tema	Faqe
MU/ML	HB	60




FIG. 2-4.3

shqetësuar të tjerët;

- Përderisa nxënësit me vetëbesim mund të ecin para programit, në konsultim me mësime të tjerë, nxënësit më të dobët mund të qëndrojnë në mësim gjersa të ndihen të sigurt se kanë përvetësuar mësimin;

4.1.4 LABORATORËT E SHKENCËS

(SHIH V2 SHTOJCËN 02 TABELËN U04 DHE R04)

Departamenti i shkencës nëpër shkollat e mesme përbëhet nga sallat e shkencës, laboratorët dhe dhomat e

përgatitjes/ruajtjes, që të gjitha këto duhet t'u nënshtrohen kushteve të njëjta teknike dhe të sigurisë.

(a) Aktivitetet

- Mësimdhënia në lëndët shkencore (fizikë, biologji dhe kimi) siç është përkufizuar në plan-programet mësimore zyrtare;
- Ligjëratat, kurset demonstruese, nganjëherë duke i përdorur mjetet audiovizuale, ushtrimet me gojë dhe me shkrim, korrigjimet në tabelë shkrimi...
- Puna praktike në grupe ku nxënësit ndahen në dy grupe (me nga 12 ose 15 deri 18 nxënës).

(b) Plani dhe kapacitetet

Laboratorët e shkencave projektohen ashtu që ata të mund të shfrytëzohen nga: (i) grupet me të gjithë nxënësit, të përbërë nga 30 deri 36 ose 24 nxënës për kurset demonstruese; dhe nga grupe të përgjysmuara me nga 15 deri 18 ose 12 nxënës për të realizuar punën praktike dhe eksperimentet nëpër nëngrupe prej 2 deri 4 nxënës.

Për arsye teknike dhe praktike, rekomandohet që tavolinat e punës të vendosen përgjatë mureve anësore (dhe nëse është e mundur përgjatë murit të pasmë) të laboratorit. Ky lloj i vendosjes do të mundësojë si punën demonstruese, ashtu edhe punën praktike, dhe ndër të tjera do të shmang shtrirjen e rrjetit në dyshe me ose nën të. Tavolinat e tilla duhet të pajisen me lavamanë, rubinete për ujë, rrymë elektrike dhe me UPS-sa.

- Tavolinat e punës të nxënësve duhet të jenë të projektuara për grupe prej 2 deri 4 nxënësish që punojnë së bashku. Pjesa e sipërme e tyre duhet të jetë rezistuese ndaj tretësirave gërryese (acideve), ndaj zjarrit, goditjeve dhe nuk duhet të jetë i materialit përçues të rrymës. Nganjëherë përdoren edhe kompjuterët për të simuluar përvojat e caktuara. Pjesa e ulët e tavolinave mund të përdoret edhe si dollapë ose rafte;
- Tavolinat e punës të arsimtarëve duhet t'i kenë specifikimet e njëjta sikur ato më lart. Ato përdoren nga arsimtarët për demonstrime, duhet të jenë të vendosur para tabelës së shkrimit dhe të kenë mjaft hapësirë të lirë përreth tyre. Përmasat minimale të tavolinave të punës të arsimtarëve duhet të jenë 0.8 m x 2.0 m;
- Tabela shkrimi duhet të jetë e ngjitur në murin e përparmë dhe mundësisht edhe në murin e pasmë. Duhet të lihet mundësia edhe për ekranin e projektorit;

- Dyert e laboratorëve shkencorë duhet të jenë 1.0 m të gjera dhe duhet të hapen jashtë dhomës. Dera e dytë duhet të jetë e vendosur në pjesën e pasme të laboratorit, me gjerësi të njëjtë, është e këshillueshme të jetë e standardeve më të mëdha (për 18/36 nxënës) për të siguruar evakuimin nga laboratorit në rast të ndonjë emergjence. Një derë tjetër do të instalohet mes laboratorit dhe dhomës së përgatitjes/ruajtjes, në afërsi të tavolinës së punës së arsimtarit.
- Tubacioni për largimin e tymit/gazit që parandalon formimin e tij dhe që mundëson zvogëlim të ekspozimit ndaj avujve toksikë, të djegshëm dhe atyre shpërthyes, si dhe ndaj grimcave që rrjedhin si pasojë e procedurave analitike dhe testuese nga laboratorit. Duhet të ketë rezistencë të mirë kimike me qëndrueshmëri dhe rezistencë të shkëlqyeshme ndaj tymit dhe avujve të nxehtë.

(c) Kushtet arkitektonike

Lokacioni i laboratorëve në godinat shkollore duhet të jetë në përputhje me njërin nga këto alternativa:

- Laboratorët shkencorë vendosen në bllok të ndarë dhe pajisen me dyer të jashtme që hapen në godinën shkollore për emergjencë të shpejta evakuimi; dhe
- Për arsye sigurie, laboratorët shkencorë mund të jenë të vendosur në katin më të sipërm si masë paraprake kundër përhapjes së zjarrit dhe për t'u izoluar nga zhurma.

(d) Kushtet për komoditet

- Ajrosja e mirë është posaçërisht e rëndësishme për komoditetin klimatik dhe për largimin e erërave, gazrave dhe të tymit;
- Kontrollimi i dritës përmes perdeve, par-

Niveli	Tema	Faqe
MU/ML	HB	62

makëve të dritares, roletneve ose hijeve është i nevojshëm për të mundësuar punë dhe eksperimente precize, atëherë kur ka nevojë për errësi (optike, elektrike, etj.);

- Lartësia e pragjeve të dritares duhet të jetë e mjaftueshme për të parandaluar shkëlqimin e fortë nga tavolinat e punës të vendosura përgjatë dritareve (dhe për të mundësuar që të ketë rubinete të ujit në pjesën e sipërme të tavolinave të punës);
- Zhurmat nga numri i madh i lëvizjeve të nxënësve dhe zhvendosja e orendive duhet minimizohet me ndihmën e copëzave të lëmuara të gomës/plastikës të vendosura në dysHEME nën këmbët e stolave dhe të tavolinave.
- Kërkohet lartësia minimale e kthinës minimum 3m (dysHEME-plafon)

(e) Kushtet e sigurisë

Hapësirat ku ruhen materiale shumë të rrezikshme ose ku zhvillohen aktivitete me rrezikshmëri të lartë (puna me materie të ndezshme, acide, materiale toksike, instrumente dhe mjete të mprehta, etj.) kërkojnë vëmendje të posaçme me qëllim të mbrojtjes së personave dhe mallrave nga zjarri dhe fatkeqësitë;

- (iii) Të gjitha hapësirat e laboratorëve janë zona me rrezikshmëri të lartë dhe duhet të mbrohen **nga zjarri**:
- Laboratori duhet të projektohet asisoj që arsimtari të mund të mbikëqyrë me lehtësi dhe nga afër eksperimentet e nxënësve;
 - Ruajtja e materialeve të djegshme duhet të bëhet larg tavolinave të punës;
 - Largimi i tymit duhet të bëhet nga dritare të larta ose tërthore ose përmes ajrosjes mekanike përveç tubacionit për largim të tymit/gazit;

- Pajisjet për shuarjen e zjarrit (kryesisht aparati për shuarje të zjarrit) duhet të sigurohet nëpër laboratorë dhe dhoma të përgatitjes (përveç pajisjeve të tjera që instalohen në hapësirat e qarkullimit);

(iv) Mbrojtja nga **rreziku nga fatkeqësitë** është po ashtu masë e rëndësishme në laboratorë:

- Për mirëmbajtje më të lehtë, rrjeti elektrik, gypat e ujit dhe të gazit mund të instalohen nëpër mure, nën tavolinat e punës me një mbrojtje efikase të konstruktit me këllëf.
- Duhet të mbahet largësia minimale prej 1.0 m ndërmjet burimit të ujit (rubineteve) dhe prizave të energjisë elektrike;
- Duhet të ketë qasje të lehtë në kutinë shpërndarëse të energjisë elektrike e cila duhet të jetë e instaluar në mur prapa arsimtarit (ose në dhomën e përgatitjes) dhe të jetë e mbyllur brenda kutisë së kyçur. Duhet të shtohet një ndërprerës elektrik i pavarur për fikje, me një ndërprerës për raste emergjencash.
- Stacionet emergjente të dushit dhe për larje të syve mund të vendosen nëpër dhomat e përgatitjes; dhe
- Duhet të sigurohen dritat emergjente për të shmangur aksidentet në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike gjatë eksperimenteve.

(f) Kushtet teknike

- (i) Mbulesat e sipërfaqeve
- Për eksperimente, trajtim të kemikaljeve dhe pastrim të lehtë, rekomandohet që muret të veshën me qeramikë deri në 2.1 m, ndërsa pjesa e mbetur e murit të lyhet me ngjyra të vajit;
 - Lavamanët duhet të jenë të punuar nga materiali që pastrohet lehtë dhe është rezistent ndaj acideve; dhe
 - Tavolinat e punës duhet të jenë të mbrojtura




FIG 2-4.4

Niveli	Tema	Faqe
MU/ML	HB	64

me pllaka mbuluese që u rezistojnë kemikaljeve dhe goditjeve.

(ii) Tubacionet

- Shmangni sa më shumë që mundeni tubacionet e fiksuara dhe mundësoni qasje të lehtë për mirëmbajtje dhe riparime; dhe
- Tubacionet shkarkuese duhet të jenë të ajrosura, rezistuese ndaj prodhimeve acidike dhe të kenë një pjerrtësi prej 1 deri 2% për evakuim të lehtë.

(iii) Furnizimi me energji elektrike

- Telat duhet të jenë të mbrojtur me këllëf;
- Sistemi i furnizimit duhet të mundësojë kërkesat për rritje të mëtejme të nevojave për energji nga pajisjet e reja.

(g) Orenditë dhe pajisjet

Artikujt specifikë për laboratorët shkencorë janë:

- Tavolinat me sipërfaqe të mbrojtura (duhet të përdoret rrëshira e poliuretanit për sipërfaqet ku kryhen eksperimentet dhe demonstrimet);
- Bankat dhe karriget për nxënës dhe arsimtarë;
- Dollapë të dukshëm në formë vitrinash;
- Kabinete për ruajtje të gjësendeve, dyert e tyre mund të jenë rrëshqitëse dhe të përdoren si tabela shkrimi;
- Tavolinat me rrotëza;
- Aparatet për shuarje të zjarrit dhe kompleti i ndihmës së parë;
- Kompjuterët dhe pajisjet e ngjashme;
- Pajisjet multimediale;
- Pajisjet shkencore laboratorike.

4.1.5 DHOMA E PËRGATITJES DHE E RUAJTJES

(SHIH V2 SHTOJCËN 02 TABELËN U05, U06, R05 DHE R06)

(a) **Plani i dhomës dhe aktivitetet**

Dhoma e përgatitjes duhet të jetë afër laboratorëve shkencorë. Ajo përdoret për përgatitje të arsimtarëve dhe për ruajtjen e pajisjeve, për vendosjen e artikujve për furnizim dhe të artikujve të shpenzueshëm. Sa herë që është e mundur, dhoma e njëjtë e përgatitjes, nëse është e vendosur mes dy laboratorëve, mund të shfrytëzohet nga dy arsimtarë të lëndëve. Në këtë rast, hapësira e sipërfaqes duhet të jetë më e madhe, tavolina e punës duhet t'i ketë dy lavamanë dhe duhet të jenë edhe dy tavolina me kompjuterë. Në këto aktivitete hyjnë përgatitja e demonstrimeve, e punëve praktike dhe e eksperimenteve që do të prezantohen në laborator, riparimi i materialeve dhe i pajisjeve, si dhe ruajtja e materialeve si dhe e pajisjeve delikate dhe të rrezikshme. Përveç qasjes së saj të drejtpërdrejtë (ose qasjeve) nga laboratorët, kjo dhomë duhet të ketë një derë për qasje të veçantë nga korridori.

(b) **Kushtet për komoditet**

- Ajrosja e mirë është thelbësore për mbrojtjen dhe konservimin e pajisjeve dhe të produkteve, si dhe për largimin e aromave, gazrave dhe të tymit; dhe
- Kërkohet ndriçim i mjaftueshëm natyral dhe artificial për dukshmëri më të mirë.

(c) **Kushtet e sigurisë**

Duhet të merren masa për të mbrojtur dhomën nga zjarri, agjentët biologjik, vjedhjet dhe vandalizmi. Këto masa përfshijnë:

- Dyer të sigurta të cilësisë së lartë;
- Instalimin e aparateve për shuarje të zjarrit;
- Mbrojtje të mirë të furnizimeve nga uji dhe tubacionet për shkarkim të ujit.





FIG. 2-4.5

(d) **Pajisjet e posaçme**

- Tubacionet për ajrosje (shih hollësitë në Laboratori paragrafi 5.1.3 (c));
- Enë të posaçme ajrosjeje për tretësira toksike dhe të paqëndrueshme; dhe
- Kabinete për mikroskop dhe instrumente tjera delikate.

4.1.6 DHOMA E ARTIT DHE DIZAJNIT

(SHIH V2 SHTOJCËN 02 TABELËN U07 DHE R07)

(a) **Aktivitetet**

Dhoma e dizajnit dhe e artit duhet të akomodojë (i) aktivitetet individuale siç janë modelimi, pikturimi, vizatimi, etj, dhe (ii) punëtoritë e artit në

grupe për nxënësit dhe mundësisht për banorët lokalë pas orarit të shkollës.

(b) **Plani dhe kapacitetet**

Për një menaxhim efikas të kësaj veprimtarie dhe për të kursyer në pajisjet që kërkohen për këtë veprimtari, rekomandohet që kjo dhomë të projektohet për grupe të përgjysmuara. Përveç kësaj, për shkollat e vogla ku numri i shfrytëzuesve është i ulët, kjo dhomë mund të kombinohet me dhomën e muzikës.

- Fleksibiliteti:** projektimi duhet të jetë fleksibil dhe i përshtatshëm për lloje të ndryshme të aktiviteteve, siç janë punimet e qeramikës, pikturimi, modelimi, etj.)
- Për punimet e artit dhe të artizanaleve, duhet

Niveli	Tema	Faqe
MU/ML	HB	66

- të vendoset një **vend për ekspozimin e tyre**;
- (iii) Duhet të vendoset së paku **një lavaman** me një ulëse të vogël dhe
- (iv) Duhet të shqyrtohet mundësia për një **depo** me rafte dhe dollapë.

(c) **Kushtet për komoditet**

- (i) Ndriçimi dhe prizat elektrikë: dritaret anësore duhet të sigurojnë mjaftë dritë natyrore. Për të errësuar dhomën nevojiten perde, hijezuese apo kanate të dritareve. Ndriçimit të rregullt nga tavanit duhet t'i shtohet edhe ndriçimi nga reflektori.
- (ii) **Akustika**: tavanet dhe muret duhet të jenë izoluese ndaj zërit dhe
- (iii) Ajrosja natyrore mund të merret nga dritaret e larta përmes pjesëve anësore.

(d) **Punët përfundimtare**

- (i) Dyshemeja: dysheme e parrëshqitshme, rekomandohet dyshemeja vinilike për sipërfaqen e dhomës së artit të përgjithshëm ndërsa dysheme e qëndrueshme në abrazion sugjerohen për sipërfaqet e modelimit dhe
- (ii) Punët përfundimtare të mureve duhet të jenë të rezistueshme dhe që mund të pastrohen:
- (iii) **tavanet**: pllakat akustike për shkurtimin e kohës së jehonës
- (iv) **Ngjyrat**: drita, ngjyrat neutrale dhe ato që anojnë nga e bardha për një ndriçim të mirë. Mundësisht të përdoren theksimet e ngjyrave nga ekspozimi i punimeve të nxënësve dhe grafikëve informative.

(e) **Kushtet e sigurisë**

- (i) Qasja: qasja e lehtë nga jashtë dhe qasje e kontrolluar nga pjesa tjetër e shkollës;
- (ii) Mbrojtje kundër vjedhjeve me dyer të sigurta të cilësisë së lartë.

(f) **Pajisjet dhe orënditë**

Orendi ergonomike dhe antropometrike:

- Karrige të palosshme njëra mbi tjetrën
- Kaluce dhe tryeza me këmbalecë dhe sirtarë;
- Perde dhe kanate të dritareve;
- Tabelë shkrimi dhe tabela të bardha
- Pajisje të vizatimit dhe të pikturimit
- Pajisjet e modelimit dhe të artizanaleve.

4.1.7 DHOMA E MUZIKËS

(SHIH V2 SHTOJCËN 02 TABELËN U08 DHE R08)

(a) **Aktivitetet**

Dhoma e muzikës akomodon grupe të madhësive të ndryshme të cilët do të interpretojnë dhe të cilët duhet të bëjnë praktikë individuale, ushtrime të ansambleve të vogla si dhe orkestra dhe kore të vogla. Megjithatë, kjo dhomë është kryesisht e caktuar për ligjërime, e jo për interpretime. Kjo dhomë duhet të akomodojë aktivitetet si në vijim:

- Muzikën instrumentale dhe atë vokale;
- Kritikën të muzikës dhe dëgjimi i muzikës
- Aktivitetet e ndërlidhura (ritmi, vallëzimi);
- Teorinë dhe historinë e muzikës dhe
- Mundësisht, kurset e muzikës për banorët lokal pas orarit të shkollës.

(b) **Plani dhe kapacitetet**

Për një menaxhim efikas të kësaj veprimtarie dhe për të kursyer në pajisjet që kërkohen për këtë veprimtari rekomandohet që kjo dhomë të projektohet për grupe të përgjysmuara. Përveç kësaj, për shkollat e vogla ku numri i shfrytëzuesve është i vogël, kjo dhomë mund të kombinohet me dhomën e artit dhe të dizajnit apo me hapësirën që përdoret për shumë qëllime. Pozicioni i rekomanduar për vendosjen e kësaj dhome do të ishte në katin përdhes, nëse është e




FIG. 2-4.6

Niveli	Tema	Faqe
MU/ML	HB	68

mundur afër hapësirës për shumë qëllime të dhe/ apo dhomës së artit dhe dizajnit meqë ato kanë veprimtari që korrespondojnë me njëra-tjetrën.

- (i) **Fleksibiliteti:** projektimi duhet të jetë fleksibil dhe i përshtatshëm për lloje të ndryshme të aktiviteteve;
- (ii) Afër dhomës së muzikës duhet të planifikohet një **depo për instrumente** në mënyrë që nxënësit t'i marrin me lehtësi instrumentet e tyre.

(c) **Kushtet teknike**

Akustika: projektimi akustik duhet të bëhet nga një ekspert i akustikës.

Për të fituar **cilësinë e zërit**, duhet të shikohet koha optimale e jehonës së zërit dhe shpërndarja e barabartë e zërit, duke përdorur materiale të posaçme për reflektimin e zërit dhe absorbimin e jehonës. **Izolimi i zërit** nga muret, dyert dhe tavani kërkohet për të shmangur shqetësimin e dhomave të tjera të mësimit. Depoja mund të përdoret si amortizues i transmetimit të zërit.

(d) **Punët përfundimtare**

- **Dyshemetë:** dysheme që nuk rrëshqasin, tepihë (varësisht nga kushtet akustike);
- **muret:** knauf të ngjyrosur me tabela për sh-pallje, panele prej materialeve të ndryshme, siç është druri i profilizuar apo shperpllaka e shpuar, mund të jenë të përshtatshme për përmirësimin e akustikës;
- **tavanet:** knauf të ngjyrosur për jehonën e kërkuar, disa shtresa të sipërme absorbuese, p.sh. pllakat akustike apo rripet prej druri me pjesë të pasme për absorbim akustik mund të vendosen për të arritur akustikën e kërkuar;
- **ngjyra:** ngjyrat e toneve të mesme zakonisht ndihmojnë në uljen e kontrastit dhe shkëlqimit. me disa sipërfaqe të vogla të ngjyrave të

errëta dhe të thella për variacion.

(e) **Pajisjet dhe orënditë**

- Tryeza dhe karrige ergonomike për dhomat e mësimit;
- Faktorët ergonomik të posaçëm gjithashtu duhet të zbatohen për karriget dhe stolet për muzikantët që ulen;
- Pupitër (mbajtëse) që përshtatet sipas nevojës;
- Dollapë, kabinete dhe rafte
- Pajisje audiovizuale
- Tabela shkrimi
-

4.1.8 DHOMA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

(SHIH V2 SHTOJCËN 02 TABELËN U09 DHE R09)

Shumë dhoma mësimi kanë kompjuterë dhe të gjitha shkollat e reja në të ardhmen do të kenë dhoma të kompjuterëve për këtë qëllim.

(a) **Aktivitetet**

- Njohja e nxënësve me punën në kompjuter dhe gjuhët kompjuterike;
- Të mësohen nxënësit për të shkruar, vizatuar në kompjuter dhe për përdorim të internetit;
- Në fund, ofrimi i kurseve për kompjuterë që do të jenë të hapura për publikun pas orëve të mësimit.

(b) **Plani dhe kapacitetet**

- Për mësimdhënie efikase dhe për t'i kursyer pajisjet e kërkuara, është e këshillueshme që të projektohet klasa për grupe të përgjysmuara (15 deri 18 nxënës në zonat urbane, 12 nxënës në zonat rurale);
- Kompjuterët mund të instalohen përgjatë të dyja anëve, përballë tabelës së shkrimit ose

në dy rreshta përballë njëri tjetrit në mes të dhomës.

- Siguroni vendkyçe të mjaftueshme për energji elektrike dhe internet ashtu që rrjeti i telave të instalohet në dysHEME ose nëpër kanale të posaçme të projektuar me qëllim të mirëmbajtjes si dhe të instalohen kyçjet për projektor në tavan;
- Shmangni shkëlqimin e fortë nga dritaret.

(c) Punët përfundimtare

- dyshemetë: DysHEME të lëmueshme;
- mure të ngjyrosura ose të veshura me pllaka gipsi të qëndrueshme në goditje;
- tavane të punuara nga pllaka akustike për të shkurtuar kohën e kumbimit;
- ngjyra me ton të mesëm që ndihmojnë në zvogëlimin e kontrastit dhe të shkëlqimit; dhe

(d) Pajisjet dhe orenditë

Nxënësit të cilët kalojnë kohë duke punuar në kompjuter të ulur në pozicion të gabuar, rrezikojnë shëndetin. Qëndrimi i dobët/i gabuar mund të shkaktojë dhimbje dhe simptoma në shpinë, qafë dhe krahë, duar, kyçe të duarve, dhe sy. Nuk ekziston ndonjë qëndrim ulur që është 'ideal' (vertikal) për shfrytëzimin e tastierës. Idealja do të ishte kur të sigurohen karrige, tavolina dhe tavolina të kompjuterit të cilat rregullohen, ashtu që lëvizja të jetë më e lehtë dhe që trupit t'i ofrohet mbështetje më e mirë. Çdo tavolinë duhet të ketë një tavolinë kompjuteri të pajisur me sirtarë, pllakë dërrase për kompjuter dhe një raft të vogël rrëshqitës për tastierë;

- Karriget e nxënësve duhet të jenë të lëvizshme, që mund të rregullohen dhe të rehatshme;
- Tabela e parë e shkrimit duhet të jetë e bardhë për të evituar pluhurin e shkumësit. Mu-

ndësisht një tabelë e dytë mund të instalohet në murin e pasmë;

- Tavolina e arsimtarit duhet të jetë e pajisur me kompjuter me sistem kabllor të rrjetit, me modem, shtypës dhe të gjitha sistemet e nevojshme të rrjeteve elektrike, UPS-ave dhe prizave;
- Tabelat e shpalljeve, dhe tabelat me kapëse;
- Varëset e rrobave të vendosura në mur.

(e) Ndriçimi

- Rekomandohet vendosja e perdeve ose e roletneve nëpër dritare për të shmangur shkëlqimin nëpër ekrane dhe për t'i mbrojtur pajisjet;
- Secila tavolinë me kompjuter duhet të jetë e pajisur me dritë të veçantë, që mund të lëvizet në tri drejtime dhe që vendoset anash kompjuterit
- Më së miri është që ekrani i kompjuterit të vendoset në pjesën pingule ndaj dritares.


(f) Kushtet për komoditet

- Parapëlqehet orientimi kah veriu për të shmangur rënien e drejtpërdrejtë të rrezeve të diellit në ekrane;
- Dhoma duhet të jetë e vendosur larg zonave të zhurmshme;
- Kompjuterët duhet të jenë të vendosur nën tavolina për të zvogëluar zhurmën.
- Materiali antistatik për mbulesë të dyshemës, mbulesat e mureve dhe ulëset me susta mund të merren në konsideratë me qëllim të zvogëlimit të zhurmës.
- Kërkohet lartësia minimale e kthinës minimum 3m (dysHEME-plafon)


(g) Kushtet teknike

- Dhoma duhet të ketë furnizim dhe ngrohje

Niveli	Tema	Faqe
MU/ML	HB	70



SALLA E KOMPJUTERËVE
15 dhe 24 nxënës



SALLA E KOMPJUTERËVE
15 dhe 24 nxënës

FIG. 2-4.7

të veçantë të pavarur që funksionon pavarësisht pjesës tjetër të shkollës, pas orarit të rregullt të mësimit në shkollë, nëse një gjë e tillë është e nevojshme. Dy priza elektrike, një vendkyçje për internet, duhet të sigurohet për secilën tavolinë të kompjuterit (duke përfshirë edhe atë të arsimtarit). Kabllot duhet të jenë të mbrojtura për siguri maksimale.

- Duhet të mbahet temperatura e rregullt dhe të bëhet ajrosja adekuate e dhomës, nëse është e mundur me kondicioner ajri ose me sistem ngrohës me pompim për të siguruar funksionim të duhur të kompjuterëve.

(h) Kushtet e sigurisë

Dhoma e kompjuterëve dhe pajisjet e saj të shtrenjta duhet të mbrohen nga vjedhja dhe vandalizmi. Megjithatë kjo dhomë duhet të jetë në dispozicion për shkollë nate.

- Në afërsi të sallës së kompjuterëve duhet të jetë një magazinë me dollapë dhe rafte të hapura dhe këto duhet të kenë një derë të përbashkët mes tyre;
- Pika e qasjes duhet të ketë vetëm një njësi dhe duhet të ketë dry të sigurisë së lartë.
- Dritaret duhet të jenë të projektuara për të parandaluar hyrjen e paautorizuar. Në katin përdhës grilat e sigurisë duhet të vendosen në secilën dritare.

4.1.9 BIBLIOTEKA DHE QENDRA MEDIALE

(SHIH V2 SHTOJCËN 02 TABELËN U10 DHE R10)

(a) Aktivitetet

Sistemet arsimore në shumë shtete janë duke i shndërruar bibliotekat tradicionale në qendra mediale, duke ju përshtatur kështu teknologjisë

së re, si dhe shumë gjërave të tjera siç është komoditeti, fleksibiliteti dhe shfrytëzimi maksimal i hapësirës. Gjithashtu, kurrikulumet e shkollave gjithnjë e më shumë po bazohen në projekte grupore dhe të bashkëpunimit. Si rezultat i kësaj, aranzhimet tradicionale dhe individuale të mësimi janë duke rënë nga përdorimi. Pra, bibliotekat e shkollave po zhvillohen në qendra të mësimi, që ofrojnë salla dhe hapësira të studimeve grupore, me qasje të mirë në burimet elektronike të informacioneve, pajisjet harduerike dhe softuerin e ndërlidhur të produktivitetit.

Planifikimi i duhur i hapësirës për nevojat e tanishme dhe zgjerimet/përshtatjet e ardhshme të bibliotekave është i domosdoshëm gjatë fazës së projektimit të shkollës. Teknologjia e kompjuterëve dhe e videove, përveç formave të tjera të medieve, përfshirë materialin e shtypur, është pjesë e rëndësishme e arsimit. Përdorimi i teknologjisë nëpër biblioteka duhet të përfshijë aspektet e projektimit që përkrahin mësimnxënien, që përfshinë ndriçimin që mund të përshtatet sipas nevojës, lidhjen e mjaftueshme elektrike, kontrollin e zërimit dhe hapësirën për zgjerim. Hapësira e bibliotekës së shkollës gjithashtu duhet të akomodojë mësimin me kompjuter që është i ndarë nga leximi i qetë, mësimet në grup, qarkullimi, puna referente dhe aktivitetet e tjera të mësimnxënies.

Aktivitetet që mund të kryhen në bibliotekë dhe në qendrën mediale janë: (i) leximet individuale nga nxënësit dhe mësimdhënësit; (ii) aktivitetet arsimore në grupe të vogla (kërkimet dhe studimet kolektive, kritikën letrare ...); (iii) qasja në internet; (iv) marrja e librave nga biblioteka; (v) vendosja e etiketave, vendosja nëpër rafte, shpërndarja dhe huazimi i librave dhe (vi) shfrytë-

Niveli	Tema	Faqe
MU/ML	HB	72

zimi nga qytetarët (komunitetin lokal) pas orarit të shkollës.

(b) Plani dhe kapacitetet

(i) Projektimi dhe plani

Për një mësimnxënie tejet efektive, objekti duhet t'i plotësojë nevojat e nxënësve dhe të personelit të shkollës dhe të bibliotekës. Qasja e lehtë në burimet e shtypura dhe ato që nuk janë të shtypura, në hapësirat komode të punës dhe të mësimit për nxënësit individualë apo për klasë të nxënësve, dhe hapësira e mjaftueshme e punës për të përmbushur nevojat e tanishme dhe të ardhshme të teknologjisë janë kërkesa themelore.

Fleksibiliteti në projektim është tejet i rëndësishëm për të mundësuar kryerjen e aktiviteteve të shumëfishta dhe për të akomoduar ndryshimet e ardhshme të kurrikulumit dhe të teknologjisë. Projektimi gjithashtu duhet të mundësojë mbikëqyrjen e lehtë të bibliotekistit dhe të mësimdhënësve përmes rrjedhës efikase të lëvizjeve, për të minimizuar pengesat. Kontrollimi i daljeve gjithashtu është i rëndësishëm: rekomandohet numër minimal i daljeve për siguri dhe rrjedhë të qetë të lëvizjeve. Biblioteka është qendër aktive e mësimnxënies dhe duhet të mundësojë akomodimin e aktiviteteve udhëzuese të shumëfishta në të njëjtën kohë. Zonat specifike të bibliotekës duhet të përfshijnë:

- Një zonë të hyrjes me:
 - Këndin e recepsionit me hapësirë të mjaftueshme për çanta;
 - Zyrën e vogël të bibliotekistit me një tavolinë të pranimit;
 - Referencat bibliografike dhe të përgjithshme;
- Pjesa e deponimit dhe të rafteve:

- Depo e librave me dhomën e rafteve dhe të procesimit;
- Raftet për pajisje;
- Këndi i ekspozimit;
- Këndi i leximit dhe i qendrës mediale
 - Hapësirat e qeta të mësimit/rekreacionit për nxënësit dhe mësimdhënësit;
 - Hapësirat audio-vizuale (TV, DVD etj.)
 - Këndi i kompjuterëve/teknologjisë;
 - Këndi i produksionit multimedial;

(ii) . Pozicionimi, kapaciteti dhe madhësia

- Biblioteka duhet të vendoset në qendër të ndërtesës në mënyrë që të jetë sa më tërheqës për nxënësit, katin përdhës, afër sallës (sallave) të kompjuterëve dhe mundësisht të jetë e orientuar drejt veriut;
- Numri i librave që duhet të vendosen në raftet e magazinës përcaktohet nga MASHT-i, në bazë të koleksioneve standarde të bibliotekave të shkollave (d.m.th. proporcioni i zakonshëm mesatar për nivelin e mesëm të lartë është 10 gjer 15 lektura për nxënësit);
- Kapaciteti i bibliotekës dhe i qendrës mediale është llogaritur në 20% të numrit të përgjithshëm të nxënësve (shfrytëzuesve), që vijnë në bibliotekë në kohë të caktuar dhe njësia e sipërfaqes është 1.4 m² për një nxënësit;

(c) Punët përfundimtare

- Dyshemetë: tepihë dhe/apo dysheme jo e rrëshqitshme;
- Muret: mure të ngjyrosura ose të veshura me pllaka gipsi të qëndrueshme në goditje;
- Tavanet: pllaka akustike për kohë të shkurtër të jehonës;
- Ngjyra: të ngrohta dhe të ndritshme.

(d) Pajisjet dhe orëditë

- Raftet për libra dhe revista;
- Banaku i bibliotekistit dhe raftet për broshura, formularë etj...
- Kutia e kartelave (dollarë të vegjël)
- Tavolina për ekspozimin e revistave e dizajnuar me kujdes me sipërfaqe të qëndrueshme, ngjyra të ndritshme dhe e përshtatshme për madhësinë e nxënësve;
- Karriget e ulëta komode me tavolina të ulëta janë të përshtatshme për leximin e rastit;
- Kompjuterët për nxënësit, mësimdhënësit dhe bibliotekistin, të pozicionuar për të shmangur shkëlqimin e dritës;
- Hapësirë pune që përshtatet sipas nevo-

jës, me sipërfaqe të rrafshët për mbajtje të shënimeve;

- Pajisje të TI-së, që përfshijnë skanerët, printerët...
- Pajisjet audiovizuale (DVD, LCD, TV, projektor të lartë, ekran, etj...).
- Makinë të fotokopjimit

(e) Kushtet e sigurisë

- Vjedhja dhe vandalizmi:** duhet të ndërmerren masa për mbrojtjen e dokumenteve dhe të pajisjeve. Këto masa përfshijnë:
 - Vetëm një hyrje/dalje përmes një dore të fortë me dry të sigurisë së lartë;

DIAGRAMI FUNKSIONAL I BIBLIOTEKËS DHE QENDRËS MEDIALE




FIG. 2-4.8

Niveli	Tema	Faqe
MU/ML	HB	74

- Vëzhgim të lehtë të hyrjeve dhe të hapësirave të brendshme;
- Raftet në hyrje për çantat e shkollës;
- (ii) **Mbrojtja e dokumenteve** duhet të bëhet përmes:
 - Izolimit kundër erës dhe pluhurit
 - Ajrosjes kundër efekteve dëmtuese të lagështisë
 - Mbrojtjes kundër dritës së diellit: nëse orientimi nga veriu nuk është i mundur, në dritare duhet të vendosen roletet, perdet dhe hijezueset;

rrethore (2 gjer 3 metra në secilën anë). Lartësia minimale është 7.0 m. Muret e skajshme duhet të lihen të zbrazët për lojërën me top, dhe dyert duhet të lihen në skaje, nëse është e mundur. Anekset e sallës duhet të përfshijnë:

- Zhveshtoret me dush/tualete (së paku dy pjesë);
- Depot për pajisje;
- Zyra e mësimdhënësit të edukatës fizike me tualet/dush dhe zhveshtore dhe
- Hapësirën për spektatorë, mundësisht në tribuna (opsionale).

4.1.10 HAPËSIRA PËR SHUMË QËLLIME

SHIH PARAGRAFIN 2.2.6 DHE DIAGRAMIN 2-2.6 PËR SALLËN PËR SHUMË QËLLIME TË NIVELIT FILLOR

4.1.11 HALLA E SPORTEVE

(SHIH V2 SHTOJCËN 02 TABELËN U11 DHE R11)

(a) Aktivitetet

Halla e sporteve duhet të mundësojë organizimin e një vargu të aktiviteteve fizike, siç janë basketbolli, volejboli, gjimnastika, vallëzimi ritmik dhe aktivitetet e tjera.

(b) Plani dhe kapacitetet

- Kapaciteti dhe sipërfaqja:** halla e sporteve duhet të ketë mundësinë e akomodimit të dy klasave në të njëjtën kohë dhe sipërfaqja mesatare neto e palestrës për nxënës është 8 m².
- Plani:** Palestra do të jetë e formës katërkëndëshe dhe së paku duhet të ketë fushën për basketboll (26 x 14 m) dhe pjesën

(c) Kushtet për komoditet

- Ndriçimi:** në tërë palestrën nevojitet ndriçim i njëtrajtshëm që mund të merret përmes dritareve të larta dhe me gjatësi të plotë të vendosura së paku në njërën anë të palestrës. Gjithashtu, nevojitet edhe ndriçimi artificial me shpërndarje të njëtrajtshme të intensitetit të dritës.
- Ngrohja:** palestra duhet që gjatë tërë kohës të ketë temperaturë komode. Gjatë dimrit duhet të mbahet temperatura minimale prej 13°C dhe duhet të shmanget sistemi i ngrohjes me gypa dhe radiatorë të ekspozuar;
- Ajrosja** natyrore përmes dritareve të larta dhe ventilim artificial;
- Akustika:** Për shkak të nivelit të lartë të zhurmës, në tavane, mure anësore dhe në dysHEME, duhet të përdoren materialet me nivel të lartë të absorbimit të zhurmës.

(d) Punët përfundimtare

Të gjitha shtresat e përfundimtare të hallës së sporteve duhet të jenë të forta dhe që mund të

FIG. 1-3.11

pastrohen lehtë:

- **Dyshemetë:** shtresa të fundit të jetë e parrëshqitshme, p.sh.: shtresa të parrëshqitshme me pjesë të pasme prej sfungjeri, rripa prej druri në dërrasat e dyshemesë, dysheme të punuara me porosi për sporte;
- **muret:** shperpllakë, dërrasa prej druri, tabela të përbëra prej grimcave, çimento i ngjyrosur i përbërë prej fijeve, tullave dhe blloqe me vrima për absorbim akustik ;
- **tavanet:** me panele prej drurit dhe leshit,

dërrasave prej druri me hapësira dhe pjesë të pasme për absorbimin akustik, metalit të shpuar me pjesë së pasme për absorbim akustik

- **Ngjyrat:** materialet natyrore dhe tonet neutrale të theksuara me ngjyra të forta të ndritshme.

(e) Kushtet e sigurisë

- Palestra duhet të ketë qasje të drejtpërdrejtë në një sipërfaqe të shtruar për evakuime të

DIAGRAMI FUNKSIONAL I HALLËS SPORTIVE




FIG. 2.4.9

Niveli	Tema	Faqe
MU/ML	HB	76

- mundshme me ambulancë;
- Dyert prej qelqi duhet të shmangen për të minimizuar aksidentet;
- Pajisjet e fiksuara të ndriçimit duhet të sigurohen me rrjeta;

(f) Pajisjet

Halla e sporteve duhet të ketë:

- Pajisjet sportive dhe të gjimnastikës;
- Pajisje të fiksuara në mure për litarë, panele të basketbollit, rrjetë të volejbollit, etj.
- Dyshekë të dyshemesë, Dyshekë të gjimnastikës dhe rrethoja;
- Pajisje të posaçme të magazinës për topa, litarë, etj.

4.2 HAPËSIRAT ADMINISTRATIVE

4.2.1 PLANI I PËRGJITHSHËM

Hapësirat administrative shërbejnë për pranimin e qytetarëve dhe të autoriteteve administrative, furnizuesve dhe prindërve. Andaj rekomandohet që ajo zonë të vendoset në afërsi të hyrjes kryesore të shkollës. Plani i saj duhet të mundësojë qasje të lehtë dhe kontrollim të lehtë të hyrjeve dhe daljeve.

Hapësirat e qarkullimit dhe ato të pritjes duhet të përcaktohen për të mundësuar qasjen e shfrytëzuesve dhe të vizitorëve, por ato duhet të jenë të ndara nga qarkullimet e klasave të mësimi për të shmangur pengimin e nxënësve si dhe të personelit administrativ të shkollës.

4.2.2 ZYRAT

